



Shqipëri - Turqi, drejt një partneriteti më të fortë në fushën e mbrojtjes



TÜRKİYE CUMHURİYETİ
MİLLÎ SAVUNMA BAKANLIĞI

» faqe 3



ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA MERR PJESË NË TAKIMET MINISTRORE TË NATO-s NË BRUKSEL

Zëvendësm ministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimet e ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, të zhvilluara në selinë e Aleancës në Bruksel. Në kuadër të këtyre takimeve, znj. Abrazhda ishte pjesë e mbledhjes së "Koalicionit të Vullnetit" dhe takimit të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës. Në këto sesione të nivelit të lartë morën pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm...



faqe 2




MINISTRI VENGU NIS ZYRTARISHT PROCESIN E RIVLERËSIMIT STRATEGJIK TË MBROJTJES

Komanda e Forcës Tokësore priti takimin e parë konsultativ për modernizimin dhe përmbushjen e objektivave të NATO-s. Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua takimi i parë konsultativ i udhëhequr nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, duke shënuar nisjen zyrtare të procesit të Rivlerësimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM). Në qendër të diskutimeve ishin modernizimi i Forcave të Armatosura dhe përmbushja...



faqe 2



"NDERI I KOMBIT FILLON ME UNIFORMËN" Me studentët e diplomuar Gentrinë, Fjodorën dhe me pedagogun, nëntoger Arlen Rama

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në zemër të Garnizonit "Skënderbej" ndodhet një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak, Akademia e Forcave të Armatosura, ku përzihen tradita dhe modernizimi, pas tre vitesh përgatitjeje intensive akademike e ushtarake, disa nga të rinjtë më të përkushtuar të vendit...



faqe 6



Ministri Vengu nis zyrtarisht procesin e Rivlerësimit Strategjik të Mbrojtjes

Komanda e Forcës Tokësore priti takimin e parë konsultativ për modernizimin dhe përmbushjen e objektivave të NATO-s.

Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua takimi i parë konsultativ i udhëhequr nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, duke shënuar nisjen zyrtare të procesit të Rivlerësimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM). Në qendër të diskutimeve ishin modernizimi i Forcave të Armatosura dhe përmbushja e objektivave të kapaciteteve të përcaktuara në Samitin e NATO-s në Hagë.

Ministri Vengu evidentoi dy përparësi kryesore të këtij procesi gjithëpërfshirës: planifikimin transparent, të bazuar në prioritetet reale, dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Në fjalën e tij, Ministri theksoi rëndësinë e modernizimit të mjeteve, pajisjeve dhe sistemeve ushtarake përmes industrisë “Made in Albania”, duke përfshirë: municionet, armatimin e lehtë, mjetet e blinduara, mjetet për emergjencat civile, artilerinë e rëndë, dronët luftarakë dhe sistemet kundër-ajrore.

Përparësia e dytë ka në fokus zhvillimin dhe specializimin e burimeve njerëzore, përmes ndërtimit të infrastrukturës së re akademike, përmirësimit të trajtimit financiar për ushtarakët dhe promovimit të karrierës ushtarake për të rinjtë shqiptarë.

Ministri Vengu vuri në dukje gjithashtu se një pjesë thelbësore e vizionit të tij është forcimi i Regjimentit të Operacioneve Speciale dhe Komandës Kibernetike, të cilat i cilësoi si dy shtylla të ekselencës në mbrojtjen shqiptare.

Po ashtu, theksoi rëndësinë e modernizimit të Mbrojtjes Civile dhe kontrollit të territorit, nëpërmjet investimeve në flotën ajrore dhe tokësore, si dhe në sistemet e monitorimit dhe komandimit në kohë reale.

Një tjetër element i rëndësishëm i këtij procesi është përditësimi i Planit Zhvillimor të Forcave të Armatosura, i cili do të ndërthuret me rritjen graduale të buxhetit të Mbrojtjes, deri në 3.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Procesi i Rivlerësimit Strategjik do të shoqërohet me konsultime të vazhdueshme në të gjitha komandat dhe me kompanitë vendase të prodhimit ushtarak, me synimin për të ndërtuar një forcë të aftë, moderne dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes. Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, drejtues të tjerë të lartë të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe përfaqësues të komandave dhe drejtorive të linjës.



Zëvendësministria Abrabhda merr pjesë në takimet ministrare të NATO-s në Bruksel

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrabhda, mori pjesë në takimet e ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, të zhvilluara në selinë e Aleancës në Bruksel.

Në kuadër të këtyre takimeve, znj. Abrabhda ishte pjesë e mbledhjes së “Koalicionit të Vullnetit” dhe takimit të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës. Në këto sesione të nivelit të lartë morën pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Mark Rutte, Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, znj. Kaja Kallas, si dhe përfaqësues të lartë të vendeve aleate.

Diskutimet u fokusuan në nevojën për të vijuar mbështetjen e qëndrueshme për Ukrainën përballë agresionit të vazhdueshëm rus dhe në hapat drejt arritjes së një marrëveshjeje armëpushimi të qëndrueshme. Aleatët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë dhe të koordinuar për forcimin e mbrojtjes dhe sigurisë në hapësirën euroatlantike.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këto takime riafirmon angazhimin e saj të palëkundur ndaj vlerave të Aleancës dhe mbështetjes për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Ministri i Mbrojtjes, vizitë në Bazën Ajrore të Farkës: Falenderon pilotët hungarezë për ndihmën në përballimin e zjarreve

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Bazën Ajrore të Farkës, ku takoi nga afër pilotët hungarezë të helikopterëve H225M, të cilët kanë ardhur në ndihmë të Shqipërisë në përballimin e vatrave të zjarrit që kanë prekur disa zona të vendit.

Ndihma është ofruar në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, dhe përbën një shembull domethënës të solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mes Shqipërisë, Hungarisë, Kroacisë dhe vendeve të tjera anëtare të BE-së në përballimin e emergjencave natyrore.

Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë e vigjilencës së lartë në orët dhe ditët në vijim, duke vlerësuar lart përkushtimin dhe profesionalizmin e mbi 1300 efektivëve civilë dhe ushtarakë që janë angazhuar në terren për menaxhimin e situatës me zjarret dhe temperaturat ekstreme. “Bashkëpunimi me vendet mike dhe strukturat europiane është kyç në përballimin e



emergjencave. Falënderoj përzemërsisht ekipet hungareze për gatishmërinë dhe mbështetjen konkrete në këto momente sfiduese për vendin

tonë”, - u shpreh ministri Vengu.

Vizita në Bazën e Farkës u mbyll me një takim pune me drejtues të Forcave Ajrore, ku



u diskutuan hapat operativë për përballimin e situatës në vazhdim dhe koordinimi me partnerët ndërkombëtarë.

Ministri Vengu në Ankara: Shqipëria e angazhuar për zhvillimin e industrisë kombëtare të mbrojtjes dhe bashkëpunimin strategjik me Turqinë

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një takim zyrtar me homologun e tij turk, z. Yaşar Güler, gjatë vizitës së tij në Ankara, në kuadër të pjesëmarrjes në Panairin e 17-të Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes – IDEF 2025.

Në këtë takim bilateral u trajtuan tema të rëndësishme që synojnë forcimin e partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Turqisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ministri Vengu vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke theksuar se kjo mbështetje është në përputhje me vendimet dhe objektivat e përcaktuara në Samitin e NATO-s në Hagë.

“Shqipëria synon të ndajë burime shtesë për zbatimin e objektivave ushtarake kryesore, me fokus në rritjen e qëndrueshmërisë operacionale të forcave ajrore, zhvillimin e industrisë së mbrojtjes dhe infrastrukturës kritike, përmes një qasjeje shumëpërdorimëshe dhe shumëqëllimëshe”, – u shpreh Ministri Vengu

Gjatë bisedimeve, një vend të veçantë zuri zhvillimi i industrisë së mbrojtjes në Shqipëri, ku Ministri nënvizoi angazhimin e qeverisë shqiptare për ta kthyer këtë sektor në një komponent të qëndrueshëm dhe konkurrues të industrisë kombëtare. Ai shprehu gatishmërinë e Shqipërisë për të shqyrtuar mundësi konkrete bashkëpunimi me kompanitë turke të mbrojtjes, përfshirë bashkëprodhimin dhe transferimin e teknologjisë, duke e cilësuar panairin IDEF 25 si një platformë reale për të avancuar këto qëllime. Në përmbyllje të vizitës në Turqi, dy ministrat nënshkruan amendimin e



Shqipëri – Turqi, drejt një partneriteti më të fortë në fushën e mbrojtjes



“Protokollit të Asistencës Financiare”, i cili parashikon pajisjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë me sisteme artilerie 105 mm, një zhvillim që përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të rritjes së kapaciteteve të mbrojtjes. Ky dokument i ri forcon kuadrin ekzistues të bashkëpunimit dhe e zgjeron atë përtej asistencës materiale, duke përfshirë fusha të tjera si trajnimet, seminarët, logjistikën, transportin dhe mbështetjen institucionale. Zbatimi i këtij protokollit do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operacionale, përmirësimin e infrastrukturës dhe fuqizimin e edukimit profesional të personelit të FA-ve.



Shqipëria, pjesë e Konferencës së 5-të të Gjenerimit të Forcës për Forcat Tokësore të Përparuara të NATO-s në Bullgari

Shqipëria mori pjesë në Konferencën e 5-të të Gjenerimit të Forcës (5th Force Generation Conference – FGC) për Forcat Tokësore të Përparuara të NATO-s (Forward Land Forces – FLF), e cila u zhvillua në Bullgari (FLF BGR). Ngjarja mbledhi përfaqësues nga vendet kontribuuese, në drejtimin e Italisë si shtet kryesor kontribuues dhe drejtues i misionit FLF BGR.

Gjatë konferencës u diskutua mbi angazhimet aktuale dhe planet e ardhshme të misionit, me fokus të veçantë në tranzicionin e njësisë nga një format i nivelit Grup-Batalion (GB) në një njësi Brigadë shumëkombëshe (Brigade – BDE), duke rritur kështu kapacitetet operacionale dhe kohezionin ndërmjet forcave aleate. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijojnë të jenë pjesë aktive e këtij angazhimi, duke kontribuar me personel dhe kapacitete, si dhe duke dëshmuar përkushtimin



e vendit ndaj arkitekturës së sigurisë kolektive të NATO-s. Kjo pjesëmarrje nënvizon rolin e Shqipërisë si një aleate e besueshme dhe e angazhuar në përpjekjet për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe përtej.



Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia përfaqëson Shqipërinë në Konferencën e 32-të të Ushtrive të Europës në Gjermani

Wiesbaden, Gjermani – Me ftesë të shefit të Shtabit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneral Randy Alan George, komandanti i Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, mori pjesë në Konferencën e 32-të të Ushtrive të Europës (Conference of European Armies – CEA), e cila u zhvillua në Komandën e Ushtrisë së SHBA-së për Europën dhe Afrikën në Wiesbaden, Gjermani.

Kjo konferencë e nivelit të lartë ushtarak kishte si temë kryesore “Ndërtimin e gatishmërisë për parandalimin global”, ku u theksua rëndësia jetike e të menduarit strategjik dhe e bashkëpunimit ndërkombëtar në përballimin e sfidave globale të sigurisë.

Gjatë zhvillimeve të saj, konferenca përfshiu diskutime të rëndësishme mbi rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet ushtrive partnere, përmirësimin kolektiv të gatishmërisë operacionale, si dhe përdorimin e të dhënave në kohë reale për analizimin dhe zhvillimin e strategjive moderne ushtarake.

Pjesëmarrja e komandantit të Forcës Tokësore shqiptare, gjeneralmajor Xhebexhia, në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar, është dëshmi e qartë e angazhimit të Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë kolektive dhe rolit të saj si partnere e besueshme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Konferenca e Ushtrive të Europës (CEA) shërben si një platformë e rëndësishme për dialog, ndarje përvojash dhe koordinim strategjik ndërmjet vendeve aleate dhe partnere të NATO-s dhe SHBA-së në Europë.

Ushtria dhe aleatët ndërkombëtarë në vijën e parë të frontit për shuarjen e zjarreve

Gjatë 24 orëve të fundit, vendi është përballur me një situatë alarmante zjarresh, me 34 vatra të raportuara, prej të cilave 8 vijnë në ende aktive, ndërsa 3 të tjera janë në monitorim të vazhdueshëm nga strukturat përkatëse. Qarqet më të prekura janë Shkodra, Lezha, Dibra, Elbasani dhe Gjirokastra, ku vatrat janë shtrirë në zona të vështira malore dhe me akses të kufizuar.

Një ndër vatrat më problematike është ajo në vendin e quajtur “Maja e Paliskës”, mbi fshatin Dukat, ku ndërhyrja e 2 helikopterëve të Forcës Ajrore solli përmirësim të situatës në orët e para, por zjarri u riaktivizua në orët e mbrëmjes. Gjatë natës, zona është mbajtur nën vëzhgim të rreptë nga forcat zjarrfikëse, ndërsa sot janë angazhuar 40 efektivë të Forcave të Armatosura së bashku me strukturat vendore për të frenuar përhapjen e flakëve. Në operacion do të ndërhyjë sërish një helikopter i Forcës Ajrore.

Një tjetër vatër kritike është ajo pranë Parkut Kombëtar të Lurës, ku ditën e djeshme u ndërhy me avionin “Canadair” kroat, të ardhur në kuadër të Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile. Edhe pse ndërhyrja ajrore solli përmirësim në njërën nga vatrat, zjarri nuk u shua plotësisht, dhe puna po vijon edhe sot nga forcat operationale në terren.

Në zonën “Përroi i Zi”, ndërhyrja e avionit kroat “Canadair” ndihmoi në ngadalësimin e përhapjes së flakëve drejt banesave dhe staneve, por kushtet e vështira atmosferike, me temperatura të larta dhe erëra të forta, e bënë të pamundur vënien nën kontroll të plotë të zjarrit. Forcat vijnë sot përpjekjet për shuarjen e kësaj vatre me perimetër të gjerë.

Nga kufiri me Mirditën, është raportuar një riaktivizim i fuqishëm i zjarrit gjatë orëve të pasdites. Sot në terren janë dislokuar për ndërhyrje 2 helikopterë nga Hungaria dhe avioni “Canadair” kroat, në kuadër të mbështetjes ndërkombëtare.



Forcat e angazhuara në operacion:

- 40 automjete zjarrfikëse
- 776 forca operationale nga strukturat vendore dhe qendrore

Gjatë ditës së djeshme:

- 345 efektivë nga Forcat e Armatosura
- 3 mjete logjistike dhe 3 helikopterë të FA
- 1 avion “Canadair” nga Kroacia
- 2 helikopterë për rikonjicion nga Hungaria

Për ditën e sotme:

- 215 efektivë të FA
- 1 helikopter i FA
- 1 avion “Canadair” kroat
- 2 helikopterë hungarezë

Sipas Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO), sot nuk priten reshje, ndërsa rreziku nga zjarret mbetet i lartë në të gjitha qarqet e vendit. Autoritetet janë në gjendje gatishmërie të plotë, duke bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat vendore dhe ndërkombëtare për menaxhimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit.

Thirrje qytetarëve: U kërkohet qytetarëve që të tregojnë kujdes maksimal dhe të shmangin çdo veprim që mund të shkaktojë zjarr. Çdo vatër e dyshuar duhet të raportohet menjëherë pranë strukturave përkatëse për të parandaluar përhapjen e flakëve dhe rrezikimin e jetës dhe pronës.

Gazeta “Ushtria” do të vijojë të sjellë zhvillimet më të fundit nga terreni dhe angazhimi i Forcave të Armatosura në këtë betejë për mbrojtjen e mjedisit dhe komuniteteve vendase.



Forca Ajrore zhvillon trajnim të përbashkët me Gardën Kombëtare të New Jersey-t në Bazën e Farkës

Forca Ajrore e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me Bazën Ajrore të Farkës, po vijon me përkushtim investimin në përgatitjen e personelit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të specializuara për misionet e kërkim-shpëtimit dhe reagimit ndaj situatave emergjente.

Këtë javë, në kuadër të Programit të Partneritetit Shqipëri-SHBA, specialistë të Gardës Kombëtare të New Jersey-t iu bashkuan ekupeve ajrore të Bazës së Farkës për të zhvilluar një trajnim të përbashkët teknik dhe operacional.

Fokusi i trajnimit ishte mirëmbajtja e helikopterëve dhe përgatitja e ekupeve ajrore për operacione në kushte të vështira, duke përfshirë situata komplekse në terren. Përmes këtij bashkëpunimi, u shkëmbyen përvoja dhe praktika të avancuara të reagimit ajror, të cilat do të ndikojnë në rritjen e kapaciteteve të operimit të Forcës Ajrore shqiptare.

Forca Ajrore ka ndërtuar ndër vite një traditë të fortë në misionet e kërkim-shpëtimit dhe ndërhyrjeve emergjente, duke shpëtuar jetë gjatë përmbytjeve të viteve 2010 dhe 2015, në evakuimin e banorëve të izoluar nga dëbora në zonat malore dhe në transportin ajror të ndihmave humanitare në raste fatkeqësish natyrore. Eksperienca e partnerëve amerikanë është vlerësuar si shumë e rëndësishme për forcimin e profesionalizmit dhe efektivitetit të Forcës Ajrore, duke garantuar një reagim të shpejtë, të koordinuar dhe efikas në çdo situatë emergjente.

Ky trajnim i përbashkët është një tjetër dëshmi e përkushtimit të Forcës Ajrore për të qenë gjithmonë pranë qytetarëve shqiptarë, në çdo cep të vendit dhe në çdo kohë. Me përgatitje të vazhdueshme dhe me mbështetjen e aleatëve strategjikë si SHBA, Forca Ajrore mbetet në shërbim të jetës dhe sigurisë së qytetarëve.

Dronët “Bayraktar” TB2 në shërbim të monitorimit dhe menaxhimit të zjarreve në të gjithë vendin

Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë ka vënë në gatishmëri dronin ajror pa pilot “Bayraktar” TB2, për të mbështetur operacionet e monitorimit dhe zbulimit të hershëm të vatrave të zjarrit që kanë përfshirë disa zona të vendit.

Falë teknologjisë së avancuar optike dhe kapaciteteve për fluturim në lartësi të mëdha dhe gjatë periudhave të gjata kohore, droni TB2 po ofron një mbështetje të paçmuar për forcat në terren, në një situatë të rënduar me zjarre të shumta aktive. Aktualisht, ky mjet ajror inteligjent po siguron: Monitorim në kohë reale, me transmetim të drejtpërdrejtë të pamjeve në qendrat e operacionit; Hartëzim të vatrave të zjarrit, duke identifikuar zonat më të rrezikuara; Zbulim të vatrave të reja, që shpesh nuk janë të dukshme nga toka; Orientim të helikopterëve dhe forcave tokësore, për të maksimizuar efektin e ndërhyrjes; Vlerësim të dëmeve, me dokumentim të zonave të djegura pas shuarjes së flakëve; Siguri për ekipet në terren, përmes identifikimit të zonave me rrezik të lartë.

Dronët TB2 janë aktivë në monitorimin e vatrave në zonat më problematike si: Parku i Lurës (Dibër), Hoçisht (Korçë), Dukat (Vlorë), Labinot-Mal (Elbasan) dhe Ulëz (Mat).

Për të forcuar kapacitetet e ndërhyrjes, janë aktivizuar gjithashtu edhe avionët “Canadair” të ardhur nga Italia dhe Greqia, të cilët kryejnë hedhje uji mbi zonat më kritike. Dronët TB2 ndjekin dhe monitorojnë në kohë reale edhe lëvizjet e avionëve ndërkombëtarë, duke siguruar një koordinim të plotë dhe rritje të efikasitetit operacional.

Situata në terren: Në Parkun e Lurës, zjarri vijon aktiv, ndërsa operacionet për shuarjen e tij po zhvillohen me intensitet. Në Ulëz, një avion italian po asiston nga ajri në ndërhyrjet vendore. Në Dukat, dy avionë grekë “Canadair” dhe një helikopter shqiptar “Cougar” janë në veprim aktiv. Në Labinot-Mal, zjarri është vënë nën kontroll dhe nuk paraqet më rrezik për banesat. Në Hoçisht të Korçës, situata po përmirësohet me ndërhyrje të vazhdueshme të forcave tokësore dhe ajrore. Ky bashkëpunim ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, i përforcuar nga përdorimi i teknologjisë së dronëve “Bayraktar” TB2, përbën një hap të rëndësishëm drejt përballimit më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikas të emergjencave natyrore në Shqipëri.



Helikopterët hungarezë dhe avioni kroat “Canadair” në ndihmë të operacioneve ajrore për shuarjen e zjarreve në Shqipëri

Kuçovë – Farkë – Shkopet – Dibër – Baza Ajrore e Kuçovës mirëpriti dy helikopterë H225M të ardhur nga Hungaria dhe një avion zjarrfikës “Canadair” nga Kroacia, në kuadër të operacioneve ajrore për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga përhapja e zjarreve në disa zona të vendit.

Menjëherë pas mbërritjes në territorin shqiptar, helikopterët hungarezë u ngritën nga Baza Ajrore e Kuçovës dhe u drejtuan për në Farkë, ku u bashkuan me një helikopter të Forcës Ajrore shqiptare për të zhvilluar operacione të përbashkëta në zonën e Shkopetit. Ekipet ajrore po veprojnë në koordinim të plotë për të siguruar monitorim ajror, orientim të forcave në terren dhe shuarje të vatrave aktive të zjarrit.

Ndërkohë, avioni zjarrfikës “Canadair” i Forcës Ajrore kroate është planifikuar të angazhohet në operacionet ajrore mbi qarkun e Dibrës, ku situata me zjarret paraqitet më kritike dhe kërkon ndërhyrje intensive. Në Bazën Ajrore të Farkës, ministri i Mbrojtjes zhvilloi një takim me pilotët e helikopterëve hungarezë H225M, duke shprehur falënderimet dhe mirënjohjen për gatishmërinë dhe ndihmën e tyre në një moment të vështirë për vendin. Ministri gjithashtu vlerësoi kontributin e Forcës Ajrore të Kroacisë, si dhe punën e palodhur të të gjithë efektivëve shqiptarë të angazhuar në terren përballë flakëve.

Këto operacione ndërkombëtare zhvillohen në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian, duke përfaqësuar një shembull të qartë të bashkëpunimit rajonal dhe solidaritetit evropian në përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Forcat Ajrore shqiptare, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, vijnë në një gatishmëri të plotë për të siguruar mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe pasurisë natyrore të vendit.



RRUGËTIMI HISTORIK I USHTRISË SHQIPTARE



Ushtria përfaqëson një shtyllë thelbësore të sovranitetit dhe sigurisë kombëtare. Ajo mbron kufijtë, siguron stabilitetin e brendshëm dhe luan një rol të rëndësishëm në rastet e fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile. Për më tepër, ajo është një simbol i unitetit dhe i forcës së kombit. Shqipëria, si pjesë e NATO-s, ka mundësi të përfitojë nga teknologjia dhe ekspertiza e aleatëve për të forcuar më tej rolin e saj në mbrojtjen kombëtare dhe rajonale.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Tre Vite Uniformë, Përkushtim dhe Krenari”

Në zemër të Garnizonit “Skënderbej” ndodhet një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak, Akademia e Forcave të Armatosura, ku përzihen tradita dhe modernizimi, pas tre vitesh përgatitjeje intensive akademike e ushtarake, disa nga të rinjtë më të përkushtuar të vendit dhe më gjerë janë gati të nisin një etapë të re në shërbim të kombit. Në mesin e tyre janë Gentrin, një djalë nga Kosova, dhe Fjodora, një vajzë nga Librazhdi, të cilët jo vetëm që kanë përfunduar me sukses formimin e tyre, por përfaqësojnë shembuj të përkushtimit, guximit dhe transformimit personal nën uniformën ushtarake.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm në vend që ofron formim të plotë ushtarak dhe arsimim të lartë për oficerët e ardhshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. E ndërtuar mbi standardet e NATO-s, me një kurrikul të përparuar që bashkon teorinë me praktikën, AFA synon të përgatisë liderë të zotë, të disiplinuar dhe të gatshëm për të përballuar sfidat e sigurisë në një mjedis kombëtar dhe ndërkombëtar në zhvillim të vazhdueshëm. Bashkë me nëntoger Arlen Ramën, pedagog dhe një nga figurat më të angazhuara në përgatitjen e brezit të ri të oficerëve, studentët ndajnë me ne përvojat, sfidat dhe emocionet që i kanë shoqëruar gjatë këtyre tre viteve. Kjo intervistë është një dritare reale mbi jetën në Akademi, një rrugëtim që shkon përtej stërvitjes dhe librave, drejt formimit të karakterit, përgjegjësisë dhe krenarisë në shërbim të atdheut.

Gentrin, ti je një prej studentëve që vjen nga Kosova. Çfarë të shtyu të bëheshe pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura në Shqipëri?

Gentriti: Ishte një dëshirë e kahershme që të bëhesha pjesë e një institucioni që formon oficerë me integritet dhe përkushtim ndaj atdheut. Shqipëria dhe Kosova kanë lidhje të ngushta kombëtare, dhe për mua, AFA përfaqësonte një derë drejt profesionalizmit ushtarak në nivel të lartë. Kur pashë thirrjen për aplikime, nuk hezitova. I shtyrë dhe i motivuar edhe nga ngjarjet e dekadave të fundit në Kosovë, vendosa të aplikoj në këtë akademi!

Si ishin ditët e para në AFA? U ndjeve i pranuar?

Gentriti: Ditët e para ishin të vështira, nuk gënjej. Ritmi i jetës këtu është krejt ndryshe, zgjime të hershme, stërvitje intensive, disiplina strikte. Por falë shokëve dhe stafit akademik, shumë shpejt u ndjeva pjesë e familjes. Ne jemi një trup, një mendje dhe aty fillon vërtet formimi si oficer.

Cili ka qenë momenti më i vështirë gjatë këtyre tre viteve?

Gentriti: Pa dyshim, stërvitjet në terren – sidomos në kushte ekstreme. Më kujtohet një ushtrim 24 orësh në terren të hapur, pa gjumë dhe në shi të vazhdueshëm. Ishte një sfidë për mendjen dhe trupin, por gjithashtu një pikë kthese që më mësoi se sa larg mund të shkoj kur nuk dorëzohem.

Dhe momenti më i paharrueshëm?

Gentriti: Ceremonia e betimit ushtarak. Ajo ndjenjë kur ngre dorën dhe betohesh për atdheun, për kombin, për dinjitetin e uniformës... nuk harrohet kurrë. Ishte emocionues dhe njëkohësisht ngarkesë e madhe shpirtërore.

Pedagogët, shtylla e arsimit ushtarak

Po për pedagogët? Si ishte marrëdhënia me ta dhe roli i tyre në këtë rrugëtim?

Ata nuk ishin thjesht mësues. Ishin udhëheqës, mentorë dhe figura që na modeluan. Kam pasur fatin të më japin mësim oficerë me eksperiencë nga misionet në Kosovë, Afganistan dhe Bosnje. Ata e ndanin me ne jo vetëm teorinë, por sidomos përvojën në terren, duke na mësuar si të vendosësh kur ka presion real. Krenaria që ndjenim kur një pedagog fliste me pasion për Shqipërinë e bënte çdo orë mësimi më shumë se thjesht leksion ishte një thirrje për atdhedashuri.



“Nderi i Kombit fillon me uniformën”

Me studentët e diplomuar Gentrin, Fjodorën dhe me pedagogun, nëntoger Arlen Rama



Gentrit Shala

Mbështetja e shtetit një investim për sigurinë
Shkolla ushtarake ka mbështetje të veçantë nga shteti shqiptar. Çfarë mund të na thoni rreth kësaj?

Gentriti: Është e vërtetë. Shteti shqiptar ofron mbështetje të plotë për çdo kadet: shkollimi është falas, sigurohet akomodimi në kushte shumë të mira, ushqimi, pajisjet, veshjet, transporti dhe gjithçka që ka të bëjë me jetesën brenda Akademisë. Për më tepër, kemi bursa mujore që na japin mundësinë të mos shqetësohemi për aspektet financiare. Kjo na lejon të fokusohemi plotësisht tek formimi ynë profesional dhe fizik.

Vlerësimi ndaj shkollës ushtarake, një derë drejt së ardhmes
Si e vlerësoni shkollën ushtarake në raport me universitetet e tjera civile?

Gentriti: Me bindje të plotë mund të them që shkolla ushtarake është ndër më të përgatiturat në vend. Jo vetëm për nga cilësia akademike, por sidomos për disiplinën, strukturën dhe përgatitjen psikofizike që ofron. Ajo nuk të përgatit vetëm për një punë, por për një mision jetësor. Një oficer i sapo diplomuar ka siguri të menjëhershme në punësim, ka të drejtën të ndjekë specializime brenda dhe jashtë vendit, dhe ka një karrierë të qartë përpara. Është një formim që të hap dyer jo vetëm në Shqipëri, por edhe në strukturat euroatlantike të sigurisë.





Fjodora, ti je një nga vajzat që përfundon me sukses Akademinë. Çfarë të shtyu ta përzgjidhje këtë rrugë?

Fjodora: Për mua, kjo ishte një thirrje personale. E rritur në Librazhd, e kam parë gjithmonë vlerën e disiplinës dhe shërbimit ndaj vendit. Kisha një dëshirë të fortë për të thyer stereotipat që vajzat nuk janë për këtë profesion. Dhe sot, pas tre vitesh, mund të them me bindje që ia vlejti çdo orë e kaluar në këtë Akademi.

Si ishte të jesh vajzë në një ambient që tradicionalisht ka qenë më i dominuar nga meshkujt?

Fjodora: Nuk ishte e lehtë. Por AFA ka krijuar një mjedis gjithnjë e më përfshirës. Përkushtimi, aftësia dhe disiplina nuk kanë gjini – dhe këtë e ndjeva që ditët e para. Unë nuk trajtohesha si “vajza e klasës”, por si një kadet që pritej të jepte maksimumin. Dhe kjo më motivoi më shumë.

Cilat janë aftësitë që ke fituar gjatë këtyre tre viteve?

Fjodora: Kam fituar më shumë sesa thjesht njohuri ushtarake. Kam ndërtuar karakter, qëndrueshmëri mendore, leadership, dhe mbi të gjitha, aftësinë për të marrë vendime nën presion. Sot ndiej se mund të përballem me çdo sfidë – jo vetëm në shërbim, por edhe në jetën personale.

Çfarë mesazhi do t’i jepje vajzave që mendojnë t’i bashkohen AFA-së?

Fjodora: Mos hezitoni! Akademia nuk është për të fortët fizikisht, por për ata që kanë vullnet të hekurt. Vajzat kanë vendin e tyre në uniformë. Nuk ka asgjë më të bukur sesa të shohësh një vajzë me kokën lart, që udhëheq me dije, përgjegjësi dhe dinjitet.

“AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA (AFA) ËSHTË INSTITUCIONI I VETËM NË VEND QË OFRON FORMIM TË PLOTË USHTARAK DHE ARSIMIM TË LARTË PËR OFICERËT E ARDHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË.

Zoti Rama, si e vlerësoni rolin e Akademisë së Forcave të Armatosura në formimin e brezit të ri ushtarak?

Arlen Rama: Akademia është baza e profesionalizmit ushtarak në Shqipëri. Këtu nuk formohen vetëm oficerë të aftë për komandë, por edhe qytetarë të ndershëm, të përkushtuar ndaj interesit kombëtar. Tre vitet e studimit janë më shumë sesa një cikël akademik ato janë një transformim i plotë në mendësi, qëndrim dhe karakter.

Si ndiheni kur i shihni studentët tuaj duke u diplomuar?

Arlen Rama: Është një ndjenjë shumë e veçantë. E ndiej si një mision të përmbushur. Kur i shoh studentët që veshin uniformën me krenari, e kuptoj se çdo orë mësimi, çdo korrigjim, çdo këshillë ka dhënë fryt. Gentriri dhe Fjodora janë shembuj të shkëlqyer të gjeneratës së re.

ndërtojmë një Akademi me standarde NATO-s. E ardhmja është premtuese dhe studentët që vijnë do të kenë mundësi të jashtëzakonshme për t’u formuar si liderë të së nesërmes.

Një mesazh për brezin që do t’ju pasojë?

Arlen Rama: Mos e merrni lehtë këtë rrugë, por nëse e zgjidhni, jepjani vetes mundësinë për t’u formuar si njerëz me vlera. Uniforma kërkon më shumë se dije, kërkon përkushtim, ndershmëri dhe sakrificë. Nëse këto i keni, Akademia do t’ju japë gjithçka tjetër.

Faleminderit të gjithëve për këtë intervistë frymëzuese. Fjalët tuaja janë më shumë se rrëfime, janë dëshmi që në këtë Akademi ndërtohet e ardhmja e sigurisë kombëtare.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Një botë ku kërcënimet nuk vijnë më vetëm me tanke, por me kablo interneti, ideologji dhe propagandë, një vend i vogël si Shqipëria duhet të mendojë si një fuqi e mençur e lidhur, e mbrojtur dhe e vetëdijshme për vendin që zë në rajon dhe botë. I tillë është kërcënimi që Shqipërisë i vjen nga Irani, megjithëse Teherani nuk ka tanke në Shqipëri, por mund të ketë lehtësisht kod në server, ide në disa faqe interneti dhe synime të tjera në heshtje. Ky shtet për ne përfaqëson një rrezik jo me uniformë, por me maskë, prandaj dhe pikërisht për këtë është e rrezikshme. Roli i inteligjencës dhe (IRGC) në kërcënimin e mundshëm ndaj Shqipërisë është kritik, sidomos në aspektin asimetrik dhe luftës së fshehtë dhe të padukshme.

Konflikti i fundit u quajt “lufta 12 ditore”, ku aktori kryesor ishte Irani, filloi më 13 dhe u mbyll më 24 qershor 2025, me sulme të befasishme ajrore nga Izraeli ndaj objekteve ushtarake dhe bërthamore iraniane, na bënë të ri-analizojmë këtë rrezik të ri. Iranit iu deshën 12 ditë për të reaguar me valë raketash dhe dronësh kundër qyteteve izraelite. Sistemi i mbrojtjes ajrore ruse S 300 u tregua i paafët ndaj sulmeve izraelite. Forcat ajrore iraniane reagueshan duke lëshuar dronë dhe raketa balistike dhe sipas burimeve iraniane, rreth 1,060 persona të vrarë përfshi 140 gra dhe fëmijë si dhe 4,475 plagosur. U arrit armëpushim, më 24 qershor, pas 12 ditësh tensioni dhe shkallëzimi të lartë të sulmeve, me ndërmjetësim ndërkombëtar. Gjatë sulmeve të përqendruara nga Izraeli, më 13 qershor, u likuiduan mbi 20 komandantë të lartë, përfshirë gjeneralin Salami, shefat e Shtabit Mohammad Bagheri dhe Gholam Ali Rashid, komandantë të forcës ajrore dhe ekspertë bërthamorë. Si rezultat, IRGC përjeton një vakum me drejtuesit strategjikë dhe teknologjikë, duke e vënë regjimin stabilitetin dhe funksionalitetin operativ të forcave iraniane, në rrezik. Struktura e komandim-kontrollit

dhe kapacitetet njerëzore janë thellësisht të dobësuar, me krizë financiare dhe morale. Hezbollah ka refuzuar të angazhohet në konfliktin Iran-Izrael, më qershor 2025, për shkak se zgjedh mbijetesën strategjike mbi sakrificën ushtarake, duke mbetur një kërcënim në rritje për të ardhmen.

Kërcënimi bërthamor iranian është ulur, por jo eliminuar plotësisht, por i vonuar ndjeshëm në objektet kryesore nukleare. Megjithatë, aftësia e Iranit për prodhimin dhe ruajtjen e uraniumit të pasuruar e bënë të pamundur eliminimin e plotë të kërcënimit në afat të shkurtër, por të vonuar deri në dy vjet. Skenarët e mundshëm për përshpejtimin e pasurimit mbeten realë, për shkak të ekspertizës dhe infrastrukturës gjysmë-operacionale që ai posedon. Irani vlerësohet se ka një stok prej 400 deri 600 kg në stokun e uraniumit me 60% nivel pasurimi, i cili është lehtësisht i përpunueshëm për të qenë bazë për armë bërthamore, e cila kërkon 90% nivel pasurimi.

Marrëdhëniet e vendit tonë me Iranin kanë histori zhvillimi në disa faza, ku periudha 1990–2012 mund të quhet neutrale dhe në distancë. Në këtë fazë marrëdhëniet kanë qenë minimale dhe të kufizuara vetëm në përfaqësim diplomatik. Nuk ka patur prani të investimeve, marrëveshjeve strategjike apo kontakte kulturore. Shqipëria ishte e orientuar drejt Perëndimit, ndërsa Irani mbante pozicione të izoluar ndërkombëtarisht. Faza e dytë 2013–2017 është edhe fillimi i tensionit për shkak të MEK. Vendimi për të strehuar MEK-un ishte vendim politik i rëndësishëm, për Iranin e lirë, i mbështetur nga SHBA dhe OKB. Irani e pa këtë mbështetje si një provokim të drejtpërdrejtë dhe filloi të shfaqte shenja presioni përmes diplomacisë së ashpër. MEK është e vetmja opozitë zyrtare në Iran, e cila e ka sfiduar regjimin e Ajatullahëve dhe shpresa e vetme e iranianeve për liri dhe demokraci. Në programin e saj

Irani dhe Shqipëria pas “luftës 12-ditore”, një analizë e rrezikut të ri

për një Iran demokratik, me zgjedhje të lira, liri të individit, të drejtat e gruas dhe heqja e dënimit me vdekje, nuk janë aspak të dëshiruara për Teheranin jo demokratik.

Faza e tretë 2018–2021 u karakterizua nga akte spiunazhi të inteligjencës iraniane në drejtim të vendit tonë. U vërejtën dhe zbuluan veprime të inteligjencës iraniane në territorin shqiptar, duke synuar atentate ndaj anëtarëve opozitare MEK. Shqipëria në këtë periudhë dëboi diplomatë iranianë dhe intensifikoi mbikëqyrjen mbi kampin e MEK, si dhe rriti praninë e SHBA-ve në fushën e sigurisë dhe teknologjisë në Shqipëri. Faza e katërt 2022–2025 është edhe kthesa e madhe, ku për pasojë u bë ndërprerja dhe përplasja kibernetike në mes dy vendeve tona. Sulmi kibernetik i vitit 2022 përbën akt agresioni dixhital të paprecedentë ndaj një vendi të NATO-s, nga Irani. Shqipëria i prishi marrëdhëniet diplomatike, duke kryer kështu një veprim të rrallë në diplomacinë moderne. Qeveria shqiptare pozicionohet qartazi si aleate strategjike e SHBA-ve në rajon, përballë Iranit dhe kërcënimeve hibride që vinin prej tij.

Nga viti 1990 ka patur një numër të organizatave dhe OJQ-ve iraniane, të cilat kanë ofruar arsim, kulturë, shkëmbime akademike dhe bursa për studentë shqiptarë, e cila zgjati deri në vitin 2019, kur ato u mbyllën si rrjedhojë e tensioneve diplomatike. Disa nga këto organizata janë: “Saadi Shirazi” Cultural Foundation, e cila është themeluar në 1995, si përfaqësuese e “Islamic Culture & Relations Organization” (ICRO) në Shqipëri. Kjo shoqatë ofronte aktivitete kulturore dhe edukative; publikonte revista akademike si “Perla”; organizonte ligjërata, seminare dhe turne në Shqipëri me akademikë iranianë dhe politikanë të parlamentit iranian për audiencën e intelektualëve shqiptarë.

“The Quran” Foundation & Saadi College është ngritur



gjatë viteve 2000 dhe drejtohej nga klerikë shiitë, përfshi nga “Al Mustafa” University në Qom. Organizata ofronte kurse për mësimin e Qur’anit në xhami të ndryshme dhe mësim mbi narrativën shiite, duke përfshirë festivale mbi fenë islame për nxënëset e gjimnazit “Saadi College”. Cultural & Religious Association “Filladi” (Breeze) është ngritur në vitin 2005, pas mbylljes së “Quran” Foundation. U themelua nga teologu shiit shqiptar Sheikh Vullnet Merja, i arsimuar në Liban. Organizata ishte aktive në edukim fetar dhe publikime në narrativë shiite. Programi i radio “Filladi” transmetonte çdo javë nga Radio Tirana ideologjinë shiite. Rumi Foundation themeluar në 2007, kishte qëllim për të promovuar studime mistike dhe filozofike iraniane. Në fillim përkthente autorë klasikë si Sayed Hossein Nasr dhe William Chittick, ndërsa më pas u orientua drejt literaturës ideologjike më radikale të Ayatullah Misbah Yazdi, duke përhapur mesazhe konservatore dhe anti perëndimore në kontekstin shqiptar. Mulla Sadra & “Kuran” Foundation në kuadër të ICRO ishte një NGO iraniane që ndihmonte ndërtimin e xhamive dhe shkollave fetare në rajon, duke ofruar edhe bursa dhe asistencë ekonomike për studentët e varfër që synonin të studiojnë Islamin në Iran (përfshi shqiptarë). “Kuran” Foundation, e lidhur me Universitetin e Qom-it “Al Mustafa”, dërgonte studentë shqiptarë për arsim të mesëm në Iran dhe përkthente libra shiite për publikun shqiptar. “Firdeus” Institute for Persian Studies, i themeluar në 2010, si bashkëpunim mes “Marin Barleti” University dhe “Saadi Shirazi” Foundation. Ishte fakulteti i parë studimor për literaturën persiane në Shqipëri, që ndihmonte përkthimin dhe studimin e teksteve klasike iraniane.

Si rrjedhim i natyrshëm i “fuqisë së butë” një pjesë e të arsimuarve shqiptarë në Iran, kanë potencial ose shfaqje ndikimi pro-Iran, jo domosdoshmërisht në mënyrë të organizuar apo të dhunshme. Kjo ndodh për faktin se në Universitetet si “Al-Mustafa” International University në Qom, ku kanë studiuar disa shqiptarë, nuk është ofruar thjesht edukim fetar. Këto universitete promovonin një version të Islamit shiit të lidhur me ideologjinë e Republikës Islamike të Iranit. Studentët që kanë studiuar aty, gjithsej në disa dhjetëra, ishin të ekspozuar ndaj një narrative politike, anti-perëndimore dhe kundër NATO-s, qëndrim i cili është në kontrast me pozicionin gjeopolitik të Shqipërisë. Studentë të arsimuar në Iran janë përfshirë më vonë edhe si ligjërues fetarë me narrativë shiite, media, organizatorë fushatash kulturore, apo imamë të xhamive dhe OJQ-ve lokale, të cilat e përçojnë dhe promovojnë narrativën iraniane. Ata ishin pjesëmarrës në

konferenca, botime dhe propagandë ideologjike. “Albania–Iran Friendship Association”, themeluar nga ish-ambasadori Iranian Zarch, ka shërbyer për të krijuar lidhje midis elitave shqiptare (politike, akademike) dhe individëve të arsimuar në Iran. Disa individë të arsimuar në Iran janë kthyer dhe përfshirë në organizata fetare, media, botime dhe aktivitete komunitare, me theks të dukshëm pro-Iran. A përbëjnë këta individë një problem të drejtpërdrejtë? Jo domosdoshmërisht, por në një situatë tensioni të lartë (si ai aktual mes Shqipërisë dhe Iranit), çdo strukturë që vepron si zgjatim ideologjik apo propagandistik i një fuqie të huaj, mund të perceptohet si kërcënim për sigurinë kombëtare. Në vitin 2020, kishte një raport i inteligjencës në kuvendin e Shqipërisë i bërë publik, i cili përmend aktivitetet e grupeve të lidhura me Iranin në Ballkan, përfshirë Shqipërinë, si qendra të ndikimit të butë dhe rekrutimit ideologjik.

Marrëdhëniet Shqipëri-Iran janë tensionuar kryesisht pasi Shqipëria ka strehuar Organizatën e Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (MEK), grupin opozitar kryesor iranian, të cilin Irani e konsideron pa asnjë të drejtë terrorist. Kjo ka shkaktuar tensione të forta diplomatike mes Tiranës dhe Teheranit dhe në vitin 2022, Shqipëria i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Iranin pas një sulmi kibernetik iranian. Ky sulm tregoi një agresion jo-konvencional, që synon destabilizimin e institucioneve tona përmes teknologjisë. Kërcënimi fizik apo terrorist është më i kufizuar megjithatë, aktivitetet e inteligjencës iraniane në rajon nuk mund të përjashtohen, veçanërisht në formë operacionesh të fshehta lufte hibride ose dezinformimi.

Kërcënimi iranian ndaj Shqipërisë është më shumë i karakterit hibrid, kibernetik dhe diplomatik, se sa konvencional. Megjithatë, ky kërcënim nuk mund të injorohet, pasi ka mundësi për të ndikuar në stabilitetin institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit tonë. Shqipëria është më e ekspozuar ndaj kërcënimit iranian në disa fusha të ndjeshme, kryesisht jo konvencionale, por që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare dhe stabilitetin institucional. Sulmet kibernetike të vitit 2022 të kryera nga grupet iraniane (si “Homeland Justice”) goditën sisteme shtetërore kritike si portali qeveritar e-Albania dhe sisteme të tjera publike. Irani përdor media të rreme, rrjete sociale dhe propagandë për të përhapur narrativa të rreme në rajone ku ka interesa. Shqipëria ishte dhe është subjekt i dezinformimit Iranian që synon të minojë besimin te qeveria, të shkaktojë përçarje shoqërore apo politike, dhe të dëmtojë imazhin e vendit

ndërkombëtarisht. Irani ka kapacitete të konsiderueshme në luftën kibernetike, dhe Shqipëria, me infrastrukturë të digjitalizuar, por ende në fillimet e saj, mbetet një objektiv i tyre në rajon. Qëllimi është destabilizimi, diskreditimi i qeverisë dhe përhapja e pasigurisë te qytetarët.

Shqipëria ka ndërmarrë një qëndrim të ashpër anti-iranian, duke ndjekur linjën e aleatëve perëndimorë, sidomos SHBA-së. Kjo qasje nga ana tjetër e vendos Shqipërinë në radarin e fushatave iraniane të dezinformimit, ku përpiqen të portretizojnë vendin tonë si “vasal amerikan” ose të minojnë legjitimitetin e tij në arenën ndërkombëtare. Edhe pse nuk ka pasur sulme terroriste direkte, ka shqetësime për aktivitet të mundshëm të agjentëve të inteligjencës iraniane në rajon. MEK (në kampin Ashraf 3 në Manzë) është opozita e vetme e cila çdo ditë po merr vlerësimet dhe mbështetjen si të brendshme iraniane ashtu edhe ndërkombëtare perëndimore. Ky fakt e nderon vendin tonë por nga ana tjetër ka një çmim; një rrezik për operacione të fshehta, si përpjekje për dezinformacion dhe “fake news” rreth statusit, aktivitetit dhe qëndrimeve të tyre siç ndodhi në qershor 2023, por edhe me infiltrimet, atentate apo shantazhe. SHBA, përmes Microsoft, Mandiant dhe FBI, ndihmuan në analizën dhe riparimin e dëmeve si dhe u rrit bashkëpunimi me BE dhe NATO, për forcimin e mbrojtjes kibernetike. Ka një bashkëpunim me BE-në dhe NATO-s kundër ndikimit malign nga aktorë të huaj, përfshirë Iranin.

Pavarësisht masave të ndërmarra, Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj kërcënimeve iraniane, veçanërisht në fushat ku kapacitetet teknike, burimet njerëzore dhe koordinimi institucional janë ende të kufizuara. Forcimi i SHISH-it, AISM dhe agjencive të tjera të inteligjencës, si dhe bashkëpunimi me i gjerë me agjencitë perëndimore është një nga hapat e parë që duhen bërë. Për të parandaluar një veprimtari armiqësore iraniane, kërkohet rritje e survejimit të aktiviteteve të huaja të dyshimta, përfshirë monitorimin e fushatave të ndikimit të huaj, në politikë, media dhe shoqërinë civile. Zhvillimi i fushatave informuese për qytetarët mbi manipulimet digjitale, dezinformimin dhe sigurinë kibernetike personale është një nga masat që duhen marrë. Krijimi i kurseve të edukimit mediatik dhe digjital në shkolla dhe universitete, është një hap i ri që duhet të vlerësohet në kushtet aktuale të zhvillimit teknologjik

Ajo çfarë pritet dhe duhet të shqetësohemi unë mendoj së është Cyber-sabotazhi i koordinuar me sulme të reja ndaj sistemeve qeveritare (TIMS, AKSHI, institucionet e drejtësisë), që paralizojnë funksione, shërbime dhe infrastrukturën kritike. Objektiva të këtyre operacioneve janë shkaktim paniku, humbje besimi publik, dhe ndëshkim për strehimin e MEK. Riaktivizimi i rrjeteve kulturore/fetare dhe rikrijimi i strukturave “soft” në zona periferike apo përmes organizatave të maskuara (p.sh. OJQ humanitare, platforma edukimi) do të synojë ndikim afatgjatë në opinion publik dhe rininë myslimane. Infiltrimi për atentat kundër figurave të MEK dhe përdorimi i agjentëve të infiltruar në komunitetin emigrant iranian për të organizuar atentate kundër anëtarëve të MEK në kampin “Ashraf 3”, mbetet një kërcënim që duhet vlerësuar.

FARSH, duke qenë pjesë aktive e strukturave të NATO-s, duke marrë pjesë në misione ndërkombëtare dhe stërvitje në kuadër të përballjes me kërcënime asimetrike, është një target i mundshëm iranian. Sulmi kibernetik iranian në 2022 ndaj institucioneve shqiptare përfshiu edhe rrjete të sigurisë, çka tregon interesin e Iranit për infrastrukturën ushtarake. Ndërsa vëmendja tani është e fokusuar në Izrael, Gaza, Liban dhe Jemen, Teherani ka kapacitet që të rikthehet me shpejtësi ndaj objektivave dytësorë ku bën pjesë edhe Shqipëria. Rrjetet e ndikimit, propaganda, dhe sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë mund të rifillojnë sapo të ulet intensiteti në Lindjen e Mesme. “Lufta 12-ditore” nuk ndryshoi qëndrimin se kush është Shqipëria në syrin e Iranit, ndoshta ajo e shtyu përkohësisht vendin tonë në fund të listës së armiqve të Teheranit. Objektivat iranianë mbeten të njëjtë, metodat janë të njohura, ritmi është ai që ndryshon. Shqipëria nuk është në fokusin taktik të momentit, por mbetet e deklaruar në listën e gjatë të kundërshtarëve strategjikë të Iranit.

Skënderbegasi i marsit 1945 – Latif Moglica

Partizani trim, ushtaraku i përkushtuar dhe nëpunësi shembullor

Nga thellësitë e Moglicës së Okshtunit në Dibër, një djalosh i brishtë, por me zemër të madhe dhe shpirt të zjarrtë atdhedashës, nisi rrugëtimin e tij në moshën 15-vjeçare drejt lavdisë, nderit dhe shërbimit për atdheun. Ky është Latif Moglica – një ndër të parët që zgjodhi t’i bashkohej shkollës ushtarake “Skënderbej” në vitin e mbramë të luftës, marsin e vitit 1945.

I lindur më 5 qershor 1929, në një familje me tradita të njohura patriotike, Latifi do të rrënjoste në vetvete idealet e luftës dhe përkushtimin ndaj vendit që në fëmijëri. Familja e tij qe një bazë e rëndësishme për lëvizjen antifashiste në zonën e Gollobordës – një trevë që diti të japë gjithçka për lirinë e Shqipërisë: bukë, strehë dhe jetë djemsh të rinj që ranë dëshmorë.

Në korrikun e vitit 1944, me zemër plot zjarr rinor dhe me ëndrrat e një luftëtari të vërtetë, Latifi u rreshtua në Brigadën e 17-të Sulmuese. Përkrah partizanëve të tjerë nga Ostreni, Trebishti, Zabzuni, ai përjetoi betejat për çlirimin e vendit, duke dëshmuar përkushtim e trimëri në çdo hap. “Kam parë shumë shokë të mi të bien, shumë sy që nuk panë më dritën e lirisë... Dhe më vjen keq që brezat e sotëm po e harrojnë atë sakrificë,” shprehet me dhimbje



e krenari Moglica, sot mbi 90-vjeçar.

Pas çlirimit, ai nuk u shkëput nga detyra ndaj vendit. Emërohet Komandant Vendi në Dibër dhe më vonë, në vitin 1947, dërgohet ndër të parët në shkollën “Skënderbej”, duke nisur formalisht karrierën e tij si ushtarak profesionist. Në vitin 1951 diplomohet në specialitetin e ndërlidhjes dhe fillon shërbimin si Shef Ndërlidhje në disa qytete si Korçë, Pogradec e më pas Elbasan, duke treguar

gjithnjë aftësi drejtuese dhe përkushtim ndaj detyrës.

Në vitin 1956, me vendimin e qeverisë “9000-shi”, doli në rezervë. Megjithatë, edhe në jetën civile, ai mbeti një shërbëtor i devotshëm i shtetit shqiptar: fillimisht si Komandant i Shkollës së Lirë Ushtarake në Librazhd, e më pas si Shef i Kuadrit në Komitetin Ekzekutiv të rrethit e më vonë në fabrikën e verës në këtë qytet. Latif Moglica përfaqëson një brez

të rrallë – një brez që nuk kurseu rininë për idealet, që nuk kërkoi privilegje, por dha gjithçka për lirinë, për ndërtimin e Shqipërisë dhe për edukimin e brezave të rinj. Sot, jeton në Librazhd, i rrethuar nga dashuria e fëmijëve, nipërve dhe mbesave – dëshmia më e bukur që vlerat e vërteta jetojnë përtej kohës.

Lavdi luftëtarëve që ndërtuan themelet e lirisë sonë. Portretet e tyre janë faqet më të ndritura të historisë kombëtare.

Ramazan Rama, nga Lufta në Bankat e Shkollës “Skënderbej”

Një jetë përkushtimi në shërbim të atdheut dhe forcave të armatosura

Historia e Ramazan Ramës është ajo e një jete të jetuar me ideal, guxim dhe përkushtim, nga fushat e luftës çlirimtare e deri në amfiteatrot e edukimit ushtarak. Një jetë që nisi me armë në dorë dhe u kurorëzua me dekada në shërbim të vendit si oficer profesionist, edukator dhe drejtues ushtarak.

I lindur më 30 korrik 1930, në fshatin Golamoran të Okshtunit të Vogël në Dibër, Ramazani u rrit në një familje të varfër, por me një pasuri të pashtershme shpirtërore – traditat e trimërisë, besës dhe dashurisë për vendin. Ende pa hyrë në moshën e adoleshencës, në moshën vetëm 13-vjeçare, ai i bashkohet Brigadës së 18-të Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke qenë një nga partizanët më të rinj të Luftës. Ish-partizanët e asaj brigade e kujtojnë me respekt si një luftëtar të pjekur përtej moshës, që spikati në përpjekjet me forcat gjermane në Kalasë e Dodës, Ploshtan, Shishtavec, Dragash, Domaj e shumë beteja të tjera.

Pas fitores së lirisë, Ramazani vijon rrugën e dijes dhe përgatitjes profesionale. Më 1 shtator 1945, ai ulet në bankat e shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej” si pjesë e brezit të parë të skënderbegasve, duke simbolizuar kalimin nga pushka tek libri, pa u shkëputur kurrë nga misioni i mbrojtjes së atdheut. Në vitin 1949 diplomohet me rezultate të larta dhe vijon menjëherë studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve. Më 8 janar 1950, emërohet oficer aktiv në specialitetin e këmbësorisë.

Karriera ushtarake e tij përfshin një itinerar të gjerë dhe të larmishëm në garnizonet e Kavajës, Burrelit, Tiranës, Shkodrës, Pogradecit e për më shumë se 25 vjet në Peshkopi. Nga viti 1960 deri më 1985, shërbeu me përkushtim në Degën Ushtarake të rrethit të Dibrës, ku mban funksionin e shefit të seksionit të dytë. Në këtë periudhë u bë një figurë kyçe për edukimin, organizimin dhe fuqizimin e strukturave ushtarake vendore.

Për kontributin e tij të vyer gjatë luftës dhe në paqe, Ramazani është dekoruar me disa medalje nderi, mes të cilave spikat “Medalja e Trimërisë” (Dekreti Nr. 1626, datë 5.2.1953), si dhe shumë dekorata dhe mirënjohje për shërbimet e tij në radhët e Forcave të Armatosura.

Pas daljes në pension, më 15 maj 1985, Ramazani nuk iu nda shërbimit ndaj shoqërisë. Jetoi në Tiranë, në lagjen “Allias”, ku u angazhua si aktivist i organizatës së Veteranëve të Luftës, si anëtar i Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë dhe si publicist në shtypin ushtarak dhe atdhetar.

Ramazan Rama mbetet një shembull i rrallë i brezit që ndërtoi themelet e lirisë dhe iu përkushtua gjithë jetën forcimit të mbrojtjes kombëtare. Kujtimi i tij është një dritë udhëheqëse për brezat e rinj të uniformës.

Partizani trim Hasan Buçpapa – Nga radhët e Brigadës V, në Shkollën “Skënderbej”

Një jetë për lirinë, shërbimin dhe përkushtimin brez pas brezi

Në rrugëtimin e lavdishëm të brezit që i dha Shqipërisë lirinë dhe themelet e një shteti modern, zë vend me nder emri i Hasan Adem Buçpapës, një ndër partizanët më të rinj të Luftës Nacionalçlirimtare dhe një nga skënderbegasit e parë të pasluftës. I lindur më 13 mars 1929, në fshatin Markaj të Tropojës, në një familje të thjeshtë fshatare, por me zemër të madhe atdhetare, Hasani u formua që i ri me ndjenjën e dashurisë për vendin, punën dhe lirinë.

Në vitin 1943, në moshë fare të re, ai lidhet me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, fillimisht si korrier dhe furnizues i batalionit territorial, duke fituar besimin dhe respektin e drejtuesve të kohës. Frymëzuar nga figura si Mehmet Mulosmani, Hasani inkadrohet në Brigadën e 25-të Sulmuese, më 6 nëntor 1944, pa i mbushur ende të gjashtëmbëdhjetat. Pavarësisht moshës, spikati në betejat e përgjakshme kundër okupatorëve nazistë, deri në Vishegrad të ish-Jugosllavisë, ku dëshmoi guxim, vendosmëri dhe trimëri të rrallë.

Pas kthimit nga Bosnja, pas kalvarit të sëmundjes që preku shumë nga partizanët në spitalin e Mitrovicës dhe sfidës që solli zjarri në atë institucion, Hasani u shërua dhe u rreshtua në radhët e Brigadës së 5-të Sulmuese, me të cilën qëndroi në Kosovë deri në pranverën e vitit 1945. Më pas, ai bëhet një nga të rinjtë që me armën e luftës në shpinë, ulet në bankat e Shkollës Ushtarake “Skënderbej”, si pjesë e brezit të parë të kadetëve shqiptarë.

Por jeta nuk ia kurseu sfidat. Me vdekjen e të atit dhe barrën e rëndë familjare mbi supe – i vetmi djalë në një familje me tre motra dhe një nënë të sëmurë – Hasani detyrohet të ndërpresë shkollimin dhe të kthehet në fshat. Atje, ai nuk e ndal asnjëherë punën për ringritjen e komunitetit të tij, që pas lufte mbeti i shkatërruar nga varfëria dhe plagët e betejave.

U martua, rriti dhe edukoi tetë fëmijë, shtatë prej të cilëve përfunduan studime të larta. Një ndër ta, gjeneral Muhamet Buçpapa, ndoqi gjurmët e babait dhe realizoi ëndrrën që Hasani nuk arriti ta çonte në fund për shkak të fatit – një ëndërr që u bë realitet me uniformën dhe gradën e lartë të të birit.

Gjatë jetës së tij, Hasani dha kontribut të veçantë për zhvillimin dhe emancipimin e zonës. Shërbeu si anëtar i Këshillit të Fshatit, Kryetar i Frontit, dhe për tetë vite si Kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës në fshatin Markaj. Në fund të jetës, u vlerësua si anëtar nderi i kësaj organizate, një simbolikë e merituar për një jetë të jetuar me nder dhe përkushtim.

Për veprimtarinë e tij të pasur në luftë dhe në paqe, Hasan Buçpapa u dekorua me medaljet “Çlirimi”, “Kujtimi”, “Trimëria”, “Medalja e Punës” dhe me dhjetëra fletë nderi për shërbime të dalluara.

Hasan Buçpapa përfaqëson idealin e brezit që nuk kërkoi asgjë, por dha gjithçka. Kujtimi i tij jeton në historinë e Luftës, në emrin e skënderbegasve dhe në rrugëtimin e një gjenerali që mban mbi supe ëndrrën e të atit.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shëfite e Sektorit të Botimeve

Sindroma e të qenit VIP: Anatomia e një iluzioni social

Epoka e famës së shpejtë dhe kriza e vlerave

Në botën moderne të komunikimit të menjëhershëm dhe konsumit të shpejtë të informacionit, një fenomen i ri ka zënë vend në ndërgjegjen kolektive të shoqërisë sonë: etja për famë. Më shumë se një qëllim, fama është kthyer në një mënyrë jetese, në një objekt lakmie të vazhdueshme që, në shumë raste, nuk lidhet më me kontributin apo vlerat, por me aftësinë për të tërhequr vëmendjen qoftë edhe përmes banalitetit apo skandalit. Kjo prirje po përshkruhet gjithnjë e më shpesh si "sindroma e të qenit VIP" një manifestim modern i një krize të thellë identiteti, ku të qenit i famshëm barazohet me të qenit i suksesshëm, pavarësisht përmbajtjes së famës.

Ky shkrim analitik synon të hulumtojë këtë sindromë në thellësi, nga rrënjët psikologjike dhe ndikimi i mediave sociale, deri tek pasojat kulturore dhe ndikimi te të rinjtë.

A po përpiqemi të kuptojmë çfarë është kjo sindromë, pse është kaq e përhapur dhe çfarë mund të bëjmë për të rikthyer balancën midis imazhit dhe thelbit.

Kur fama zë vendin e vlerës

"Sindroma e të qenit VIP", nuk është një term i institucionalizuar. Thelbi i kësaj sindrome qëndron në: Ndërtimin e identitetit përmes perceptimit publik, jo përmes vetëdijes së brendshme. Matjen e vlerës personale përmes ndjekësve, pëlqimeve dhe komenteve. Krijimin e një realiteti virtual të idealizuar që zëvendëson jetën reale.

Të jesh VIP, në kuptimin klasik të fjalës, do të thotë të jesh person i rëndësishëm për shoqërinë, me ndikim të vlefshëm dhe që kontribuon në mirëqenien kulturore, shkencore apo ekonomike. Në formën e deformuar që kjo ide ka marrë sot, 'VIP' është kushdo që bie në sy, qoftë edhe përmes një skandali. Kjo është rënia më dramatike e standardeve të vlerësimit social në dekadat e fundit.

Si ndryshoi koncepti i njohjes

Historikisht, fama ishte rezultat i përpjekjeve të jashtëzakonshme në art, shkencë, sport, letërsi apo diplomaci. Ajo ishte shpërblimi për kontributin dhe jo qëllimi në vetvete. Por me përhapjen e televizionit, më pas të internetit dhe së fundmi të rrjeteve sociale, ky koncept ndryshoi rrënjësisht.

Në realitetin e sotëm digjital, individë që nuk kanë asnjë aftësi të dalluar mund të bëhen të famshëm brenda natës, përmes një videoje virale, një deklarate ekstreme apo një fotografie provokuese. Platforma si Instagram, TikTok apo YouTube kanë krijuar një model "prodhimi famë" që nuk kërkon më përgatitje, përmbajtje apo përkushtim. Ato kërkojnë vetëm shfaqje: sa më e pazakontë apo më ekstreme, aq më mirë.

Narcizmi dhe vetëvlerësimi i rremë

Nga pikëpamja psikologjike, sindroma e të qenit VIP lidhet ngushtë me narcizmin, një prirje për të mbivlerësuar rëndësinë personale dhe për të kërkuar vazhdimisht vëmendje e admirueshmëri nga të tjerët. Kjo sjellje shpesh shfaqet tek individë që vuajnë nga: Mungesa e identitetit të brendshëm, që e kërkojnë vërtetimin e vetes jashtë vetes; Vetëbesim i brishtë, që duhet ushqyer vazhdimisht me pëlqime dhe komente; Ankth i fshehur, që maskohet me një imazh të ndërtuar për t'u pranuar.

"Etja për famë është shpesh një mënyrë për të kompensuar një ndjenjë të brendshme boshllëku dhe mungese identiteti".

Kur identiteti ndërtohet mbi një imazh virtual, çdo goditje e atij imazhi, si mungesa e reagimeve apo kritikë publike përjetohet si një kërcënim ekzistencial. Kjo krijon një cikël të pashëndetshëm emocional që dëmton shëndetin mendor të individëve, veçanërisht të rinjve.

Media dhe rrjetet sociale: Prodhuesit industrialë të VIP-ave

Platforma si Instagram dhe TikTok janë ndërtuar për të nënvizuar dukshmërinë dhe jo thelbin. Kjo e bën përmbajtjen cilësore të vështirë për t'u dalluar.

Rrjetet sociale nuk janë më mjete komunikimi, por janë kthyer në skena

personale, ku secili është aktor, regjisor dhe spektator i vetvetes.

Në këtë shfaqje të përhershme, "VIP-i" nuk është më ai që jep, por ai që duket.

Shto këtu dhe ndikimin e mediave tradicionale që i japin hapësirë të pamatë figurave që prodhojnë zhurmë, dhe ke një formulë perfekte për një shoqëri që glorifikon fasadën dhe jo substancën.

Pasojat sociale dhe kulturore:

Kriza e vlerave tek të rinjtë

Ndikimi më i thellë i sindromës së të qenit VIP shihet te të rinjtë, të cilët janë më të ekspozuar ndaj ndikimeve vizuale dhe më të brishtë emocionalisht.

Disa nga pasojat më shqetësuese përfshijnë: Ulja e motivimit për arsimim dhe punë të ndershme, pasi fama duket më e lehtë për t'u arritur; Rritja e krahaseve të pashëndetshme, që çon në ulje të vetëbesimit; Ndërtimi i imazheve të rreme, për t'u përshtatur me pritshmëritë e rrjeteve sociale; Dëmtime të shëndetit mendor si ankthi, depresioni,

vetmia dhe izolimi.

Ky realitet përbën një sfidë për shkollat, familjet dhe institucionet kulturore, të cilat shpesh ndihen të pafuqishme përballë presionit që rrjetet sociale ushtrojnë mbi të rinjtë.

Shoqëri që shpërblen zhurmën:

Paradoksi i famës boshe

Sot jetojmë në një kulturë që e ka kthyer zhurmën në vlerë. Skandali është monedha e re. Diskutimi etik është zëvendësuar nga spektakli. Suksesi nuk matet më me ndikimin pozitiv që një individ lë në komunitet, por me klikimet dhe vëmendjen që arrin të tërheqë.

Në këtë realitet, VIP-i është një figurë e paqëndrueshme, një produkt i algoritmeve dhe trendeve të momentit, që harrohet me të njëjtën shpejtësi me të cilën u ngrit. Ironia është se kjo famë nuk lë gjurmë. Është famë që harrohet.

Drejt një kulture të re: Edukimi

dhe përgjegjësi mediatike

Zgjidhja nuk është ndalimi i rrjeteve sociale apo kthimi pas në kohë, por ndërtimi i një kulture të re mediatike dhe sociale, e cila promovon: Modelin e suksesit të bazuar në kontribut, jo në shfaqje. Edukim mediatik, për të ndihmuar të rinjtë të kuptojnë realitetin pas filtrave. Përgjegjësi nga mediat dhe platformat sociale, për të mos glorifikuar sjellje të dëmshme.

Rikthimi i figurave frymëzuese në hapësirën publike, nga mësuesit e deri te artistët me vlerë.

Shkollat dhe institucionet edukative duhet të mësojnë të rinjtë se vlerat e vërteta nuk maten me ndjekës, por me ndikimin që lëmë në jetët e të tjerëve.

Të jesh VIP në dimensionet e fjalës

Të jesh VIP' nuk është të jesh i famshëm, është të jesh i dobishëm. Të kontribuosh. Të frymëzosh. Të ndihmosh të tjerët të rriten dhe të zhvillohen. Në një botë që të nxit të dukesh, zgjedhja më radikale është të jesh vetvetja.

Le të mos rrisim një brez që ëndërron të jetë i famshëm. Le të rrisim një brez që ëndërron të jetë i vlefshëm.



Deklaratë dënimi nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në lidhje me aktivitetet kibernetike dashakeqe të Rusisë

Deklarata e NATO-s – Forcë Përmes Solidaritetit Kibernetik

Në një epokë ku fushat e betejës dixhitale janë po aq të rëndësishme sa ato në tokë, det dhe ajër, aleanca transatlantike përballet me një valë në rritje të aktivitetit kibernetik keqdashës. Deklarata e mëposhtme riafirmon vendosmërinë e unifikuar të NATO-s për të kundërshtuar dhe dënuar operacionet e vazhdueshme kibernetike dhe hibride të Rusisë që synojnë aleatët dhe partnerët. Ndërsa këto kërcënime përshkallëzohen - duke minuar sigurinë, sovranitetin dhe normat ndërkombëtare - NATO qëndron e vendosur në angazhimin e saj për mbrojtje kolektive, qëndrueshmëri dhe respektim të sundimit të ligjit në hapësirën kibernetike. Kjo deklaratë nuk është thjesht një përgjigje; është një thirrje për veprim, unitet dhe llogaridhënie në mbrojtjen e kufirit dixhital:

“Ne dënojmë fuqimisht aktivitetet kibernetike dashakeqe të Rusisë, të cilat përbëjnë një kërcënim për sigurinë e Aleatëve. Ne qëndrojmë në solidaritet dhe pranojmë që Estonia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara ia kanë atribuuar së fundmi aktivitetin kibernetik dashakeq që synon disa aleatë të NATO-s dhe Ukrainën, shërbimit të inteligjencës ushtarake të Rusisë (GRU). Kujtojmë se në vitin 2024, Gjermania dhe Republika Çeke ia atribuuan individualisht aktivitetin APT 28, i cili sponsorizohet nga GRU. Gjithashtu vërejmë me shqetësim se i njëjti aktor kërcënim shënjestroi entitete të tjera qeveritare kombëtare, operatorë të infrastrukturës kritike dhe entitete të tjera në të gjithë Aleancën, përfshirë Rumaninë. Këto atribuime dhe shënjestrimi i vazhdueshëm i infrastrukturës sonë kritike, me ndikimet e dëmshme të shkaktuara në disa sektorë, ilustrjnë shkallën në të cilën kërcënimet kibernetike dhe kërcënimet hibride më të gjera janë bërë mjete të rëndësishme në fushatën e vazhdueshme të Rusisë për të destabilizuar aleatët e NATO-s dhe në luftën brutale dhe të paprovokuar të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.

Ne i bëjmë thirrje Rusisë të ndalojë aktivitetet e saj destabilizuese kibernetike dhe hibride. Këto aktivitete demonstrjnë shpërfilljen e Rusisë për kornizën e Kombeve të Bashkuara për sjellje të përgjegjshme shtetërore në hapësirën kibernetike, të cilën Rusia pretendon se e mbështet. Veprimet e Rusisë nuk do ta pengojnë mbështetjen e Aleatëve për Ukrainën, duke përfshirë ndihmën kibernetike përmes Mekanizmit të Talinit dhe koalicionit të aftësive IT. Ne do të vazhdojmë të përdorim mësimet e nxjerra nga lufta kundër Ukrainës në kundërshtimin e aktivitetit kibernetik dashakeq rus.

NATO mbështet një hapësirë kibernetike të lirë, të hapur, paqësore dhe të sigurt. Ne u bëjmë thirrje të gjitha shteteve, përfshirë Rusinë, të përmbushin detyrimet e tyre ndërkombëtare, edhe kur veprojnë në hapësirën kibernetike, dhe të veprojnë në përputhje me kornizën për sjellje të përgjegjshme shtetërore në hapësirën kibernetike, siç është afirmuar nga të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara.

Ne mbetemi të bashkuar në vendosmërinë tonë për të kundërshtuar dhe kufizuar aktivitetet kibernetike dashakeqe ruse dhe po investojmë në mbrojtjen tonë; duke përfshirë krijimin e Qendrës së Integruar të Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s dhe duke përmbushur angazhimet tona të Premtimit të Mbrojtjes Kibernetike, si dhe përmes angazhimeve të bëra në Deklaratën e Samitit të Hagës.

Ne jemi të vendosur të përdorim gamën e plotë të aftësive për të penguar, mbrojtur dhe kundërshtuar spektrin e plotë të kërcënimeve kibernetike. Ne do t'u përgjigjemi këtyre në një kohë dhe në një mënyrë që zgjedhim ne, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe në koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë, përfshirë BE-në.”



Kjo deklaratë pasqyron qëndrimin e vendosur të NATO-s kundër operacioneve të vazhdueshme kibernetike dhe hibride të Rusisë, të cilat i janë atribuar GRU-së dhe grupit të sponsorizuar prej saj APT 28. Dënimi nxjerr në pah një model aktiviteti dashakeq që synon aleatët e NATO-s dhe Ukrainën, duke përfshirë infrastrukturën kritike dhe entitetet qeveritare në të gjithë Evropën - si në Rumanë, Gjermani dhe Republikën Çeke.

NATO thekson se këto veprime shkelin kornizën e OKB-së për sjellje të përgjegjshme shtetërore në hapësirën kibernetike dhe riafirmon angazhimin e Aleancës për të mbështetur Ukrainën përmes iniciativave si Mekanizmi i Talinit dhe koalicioni i aftësive IT. Deklarata gjithashtu nënvizon strategjinë më të gjerë të mbrojtjes kibernetike të NATO-s, duke përfshirë krijimin e Qendrës së Integruar të Mbrojtjes Kibernetike dhe zbatimin e premtimeve të bëra në Samitin e Hagës.

Në thelb, NATO po sinjalizon se nuk do të tolerojë kërcënimet destabilizuese kibernetike dhe do të përgjigjet me vendosmëri, duke përdorur të gjitha mjetet e disponueshme dhe në koordinim me partnerë si BE-ja.

Rritja e kapacitetit të mbrojtjes kibernetike të NATO-s

Mbrojtja kibernetike ka të bëjë po aq shumë me njerëzit sa edhe me teknologjinë. NATO vazhdon të përmirësojë gjendjen e mbrojtjes së saj kibernetike përmes edukimit, trajnimit dhe ushtrimeve.

NATO kryen ushtrime të rregullta, siç është Ushtrimi vjetor i Koalicionit Kibernetik, dhe synon të integrojë elementët dhe konsideratat e mbrojtjes kibernetike në të gjithë gamën e ushtrimeve të Aleancës, duke përfshirë Ushtrimin e Menaxhimit të Krizave (CMX). NATO gjithashtu po rrit aftësitë e saj për edukim dhe trajnim, duke përfshirë Poligonin Kibernetik të NATO-s, i cili është i vendosur në një strukturë të ofruar nga Estonia. Në nëntor 2023, NATO mbajti Konferencën e parë gjithëpërfshirëse të Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s në Berlin, duke bashkuar

vendimmarrësit në të gjitha nivelet politike, ushtarake dhe teknike.

NATO ka një numër mjetesesh praktike për të rritur ndërgjegjësimin për situatën dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë pikat e kontaktit me autoritetet kombëtare të mbrojtjes kibernetike në të gjitha kryeqytetet aleate. Një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) i dedikuar përcakton rregullimet për shkëmbimin e një sërë informacionesh dhe ndihme të lidhura me mbrojtjen kibernetike për të përmirësuar parandalimin, rezistencën dhe aftësitë e reagimit ndaj incidenteve kibernetike.

Informacioni teknik shkëmbehet gjithashtu përmes Platformës së Ndarjes së Informacionit mbi Malware-in e NATO-s, e cila lejon që treguesit e kompromentimit të ndahen me shpejtësi midis mbrojtësve kibernetikë aleatë, duke përforcuar qëndrimin e përgjithshëm mbrojtës të Aleancës.

Qendra e Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike Bashkëpunuese e NATO-s (CCDCOE) në Talin të Estonisë është një qendër shumëkombëshe dhe ndërdisiplinore e mbrojtjes kibernetike e akredituar nga NATO për ekspertizë të njohur dhe përqendrohet në edukimin, konsultimin, mësimet e nxjerra dhe kërkimin dhe zhvillimin e mbrojtjes kibernetike. Nuk është pjesë e Strukturës së Komandës së NATO-s.

Akademia e Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s (NCI) në Oeiras të Portugalisë ofron trajnime për personelin nga vendet aleate (si dhe jo-anëtare të NATO-s) në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit dhe informacionit të NATO-s. Akademia NCI gjithashtu ofron trajnime dhe edukim për mbrojtjen kibernetike.

Shkolla e NATO-s në Oberammergau të Gjermanisë kryen edukim dhe trajnime të lidhura me mbrojtjen kibernetike për të mbështetur operacionet, strategjinë, politikën, doktrinën dhe procedurat e Aleancës.

Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s në Romë të Italisë nxit të menduarit strategjik mbi çështjet politiko-ushtarake, duke përfshirë çështjet e mbrojtjes kibernetike.

Armët e Inteligjencës Artificiale përfaqësojnë një revolucion teknologjik që e transformon luftën moderne, por njëkohësisht sjell një sërë problematikash të thella. Një nga shqetësimet kryesore është se AI-ja mund të ulë pragun për nisjen e luftërave, pasi eliminon nevojën për angazhimin e drejtpërdrejtë të ushtarëve. Sistemet autonome shpesh operojnë pa ndërhyrje njerëzore, gjë që rrit rrezikun për vendime të gabuara, sulme të paautorizuara dhe humbje të kontrollit etik. Në shumë raste, prezenca e një operatori njerëzor mbetet simbolike, pa pasur ndikim real në vendimmarrje. Kjo e zbeh ndjeshëm përgjegjësinë morale dhe ligjore për përdorimin e forcës. IA po bëhet gjithashtu një mjet i mundshëm për keqpërdorim nga aktorë të paautorizuar, që nga armët biologjike sintetike deri te sulmet kibernetike. Në nivel global, po zhvillohet një garë për armatim me AI-në, duke rritur tensionet ndërkombëtare dhe pasigurinë. Rregullimi mbetet sfidë, pasi shumë ekspertë paralajmërojnë se përdorimi i AI-së në vendime kritike si ato bërthamore nuk duhet të lejohet kurrë. Për më tepër, paqartësia mbi autonominë e sistemeve, ndikimi negativ në kërkimet shkencore civile, si dhe dobësimi i lidhjes mes luftës dhe kostos njerëzore janë elemente që e bëjnë këtë çështje tejet komplekse dhe urgjente për t’u adresuar.

Nëse një armë e AI-së është autonome, ajo duhet të ketë aftësinë për perceptim të saktë. Kjo do të thotë, nëse ngatërrojnë një makinë civile me një objektiv ushtarak, shkalla e reagimit të saj nuk është e rëndësishme. Civilët në makinë vdesin pavarësisht kësaj.

Në shumë raste, sistemet e AI-së kanë shkëlqyer në perceptim, pasi makinat dhe algoritmet e mundësuar nga AI-ja janë rafinuar. Kur, për shembull, ushtria ruse kreu një provë me 80 UAV që fluturonin njëkohësisht mbi fushat e betejës siriane me vizualizim të unifikuar, atëherë ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu e krahasoi atë me një “film gjysmë fantastik” që zbuloi të gjitha objektivat e mundshëm.

Por problemet mund të shfaqen. Në hartimin e një arme me inteligjencë artificiale, zhvilluesit së pari kanë nevojë për qasje në të dhëna. Shumë sisteme të inteligjencës artificiale trajnohen duke përdorur të dhëna që janë etiketuar nga një sistem ekspert (p.sh., etiketimi i skenave që përfshijnë një bateri mbrojtëse ajrore), zakonisht një njeri.

Aftësia e përpunimit të imazhit të një intelligence artificiale nuk do të funksionojë mirë kur i jepen imazhe që janë të ndryshme nga grupi i saj i trajnimit - për shembull, fotografi të prodhuara ku kushtet e ndriçimit janë të dobëta, që janë në një kënd të trashë ose që janë pjesërisht të errësuar. Sistemet e njohjes së inteligjencës artificiale nuk e kuptojnë se çfarë është imazhi; përkundrazi, ato mësojnë tekstura dhe gradiente të pikselëve të imazhit. Kjo do të thotë që një sistem me inteligjencë artificiale mund të njohë saktë një pjesë të një imazhi, por jo tërësinë e tij, gjë që mund të rezultojë në klasifikim të gabuar.

Për të mbrojtur më mirë inteligjencën artificiale nga imazhet mashtruese, inxhinierët i nënshtrojnë ato në “trajnimin kundërshtar”. Kjo përfshin ushqyerjen e një klasifikuesi me imazhe kundërshtare në mënyrë që të mund të identifikojë dhe injorojë ato që nuk do të synohen.

Hulumtimi nga Nicolas Papernot, një student i diplomuar në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë, tregon se një sistem, madje i mbështetur nga trajnimi kundërshtar, mund të jetë joefektiv nëse mbingarkohet nga numri i madh i imazheve. Imazhet kundërshtare përfitojnë nga një veçori që gjendet në shumë sisteme të inteligjencës artificiale të njohura si “kufijtë e vendimmarrjes”.

Këto kufij janë rregullat e padukshme që udhëzojnë një sistem nëse ai percepton një luan apo një leopard. Objektivi do të ishte krijimi i një harte mendore me luanë në një sektor dhe leopardë në një tjetër. Vija që ndan këta dy sektorë - kufiri në të cilin një luan bëhet leopard ose leopardi luan - njihet si kufiri i vendimmarrjes.

Jeff Clune, i cili ka studiuar gjithashtu trajnimin kundërshtar, mbetet dyshues në lidhje me sisteme të tilla klasifikimi, sepse ato janë shumë arbitrare. “E tëra çfarë po bëni me këto rrjete është t’i stërvitni ato për të vizatuar vija midis grupeve të të dhënave në vend që të modelojnë thellësisht atë që do të thotë të jesh një leopard ose një luan”.

Sete të mëdha të dhënash shpesh etiketohen nga kompanitë që përdorin metoda manuale. Marrja dhe ndarja e seteve të të dhënave është një sfidë, veçanërisht për një organizatë që preferon të klasifikojë të dhënat dhe të kufizojë aksesin në to.

Një set i të dhënave ushtarake mund të përmbajë imazhe të prodhuara nga sistemet e imazherisë termike, për shembull, por nëse ky set i të dhënave nuk ndahet me zhvilluesit, një armë e inteligjencës artificiale nuk do të ishte aq efektive. Për shembull, pajisjet e inteligjencës artificiale që mbështeten në chatbot-e të kufizuara në qindra fjalë mund të mos jenë në gjendje ta zëvendësojnë plotësisht një njeri me një fjalor shumë më të gjerë.

Sistemet e inteligjencës artificiale pengohen gjithashtu nga pamundësia e tyre për të kryer shumë detyra njëkohësisht. Një njeri mund të identifikojë një automjet armik, të vendosë për një sistem arme për ta përdorur kundër tij, të parashikojë rrugën e tij

Dobësitë e Armëve të AI-së



dhe pastaj të angazhohet me objektivin. Një sistem i inteligjencës artificiale nuk mund t’i dyfishojë këto hapa.

Në këtë pikë, një sistem i trajnuar për të identifikuar një tank T-90 ka shumë të ngjarë të mos jetë në gjendje të identifikojë një tank kinez të Tipit 99, pavarësisht faktit se të dy janë tanke dhe të dy detyrat kërkojnë njohje të imazhit. Shumë studiues po përpiqen ta zgjidhin këtë problem duke punuar për t’i mundësuar sistemeve të transferojnë të mësuarit e tyre, por sisteme të tilla janë vite larg prodhimit.

Siç pritej, kundërshtarët do të përpiqen të përfitojnë nga këto dobësi duke mashtruar motorët dhe sensorët e njohjes së imazheve. Ata gjithashtu mund të përpiqen të kryejnë sulme kibernetike për të shmangur sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve ose për të furnizuar me të dhëna të ndryshuara sistemet e inteligjencës artificiale që do t’u furnizojnë atyre me kërkesa të rreme.

Etika e përdorimit të AI-së

Edhe pse përdorimi i armëve autonome ka qenë subjekt debati për dekada, pak vëzhgues presin që ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të vendosë rregullore të reja, veçanërisht pasi SHBA-të, Kina, Izraeli, Rusia dhe të tjerë garojnë për të zhvilluar armë edhe më të përparuara.

“Gjeopolitika e bën të pamundur”, thotë Alexander Kmentt, negociatori kryesor i Austrisë për armët autonome në OKB. “Këto armë do të përdoren dhe do të përdoren në arsenalin ushtarak të pothuajse të gjithëve”.

Pavarësisht sfidave të tilla, Human Rights Watch ka bërë thirrje për “negociatat urgjente dhe miratimin e një instrumenti ligjërisht të detyrueshëm për të ndaluar dhe rregulluar sistemet autonome të armëve”. Ajo ka nisur Fushatën për të Ndaluar Robotët Vrasës, të cilës organizata e të drejtave të njeriut thotë se i është bashkuar më shumë se 270 grupeve dhe 70 vendeve.

Edhe pse polemika është përqendruar rreth armëve autonome, Brian Schimpf, CEO i prodhuesit të dronëve të AI-së “Anduril”, ka një perspektivë tjetër. Ai thotë se armët e inteligjencës artificiale “nuk kanë të bëjnë me nxjerrjen e njerëzve nga loja. Nuk mendoj se ky është kuadri i duhur etik. Kjo ka të bëjë me mënyrën se si i bëjmë vendimmarrësit njerëzorë më efektivë dhe më të përgjegjshëm për vendimet e tyre”.

Gjithsesi, armët autonome të inteligjencës artificiale janë tashmë në zhvillim e sipër. Përveç etikës së mbështetjes në një armë për të marrë vendime për jetë a vdekje, ekziston një problem me vetë inteligjencën artificiale. Gabimet dhe llogaritjet e gabuara janë relativisht të zakonshme. Algoritmet që qëndrojnë në themel të operacioneve të sistemeve të inteligjencës artificiale janë të afta të bëjnë gabime – “halucinacione” - në të cilat rezultatet në dukje të arsyeshme rezultojnë të jenë plotësisht iluzione.

Kjo mund të ketë implikime të thella për vendosjen e armëve

të inteligjencës artificiale që veprojnë me udhëzime thellësisht të gabuara të pazbulueshme nga operatorët njerëzorë. Në një skenar veçanërisht distopik, një kundërshtar mund të zëvendësojë gjeneralët robotë me ata njerëzorë, duke e detyruar SHBA-në të bëjë të njëjtën gjë, me rezultatin që sistemet e inteligjencës artificiale mund të përballen me njëri-tjetrin në fushën e betejës me pasoja të paparashikueshme dhe ndoshta katastrofike.

Dr. Elke Schwarz e Universitetit “Queen Mary” të Londrës e sheh dilemën e armëve të inteligjencës artificiale përmes një kuadri teorik që mbështetet në shkencën politike dhe hetimet empirike në shqyrtimin e saj të dimensioneve etike të inteligjencës artificiale në luftë. Ajo beson se integrimi i sistemeve të armëve të mundësuar nga inteligenca artificiale lehtëson objektivizimin e objektivave njerëzorë, duke çuar në një tolerancë të shtuar për dëmet kolaterale.

Sipas saj, automatizimi mund të “dobësojë agjencinë morale midis operatorëve të sistemeve të synimit të mundësuar nga inteligenca artificiale, duke zvogëluar aftësinë e tyre për vendimmarrje etike”. Paragjykimi ndaj sistemeve autonome mund të inkurajojë gjithashtu industrinë e mbrojtjes të nxitojë me kokëfortësi në financimin e sistemeve ushtarake të inteligjencës artificiale, “duke ndikuar në perceptimet e përdorimit të përgjegjshëm të inteligjencës artificiale në luftë”. Ajo i nxit politikëbërësit të marrin në konsideratë rreziqet para se të jetë tepër vonë.

“Efekti i inteligjencës artificiale është shumë, shumë më tepër sesa mitralozi ose aeroplani. Është më shumë si kalimi nga fuqia e muskujve në fuqinë e makinës në Revolucionin e fundit Industrial”, thotë Peter Singer, një profesor në Universitetin Shtetëror të Arizonës dhe një strateg dhe bashkëpunëtor i lartë në grupin amerikan të mendimit New America, i cili ka shkruar gjerësisht për inteligjencën artificiale dhe luftën.

“Unë besoj se ardhja e inteligjencës artificiale në anën e softuerit dhe zbatimi i saj në robotikë në anën e harduerit është ekuivalenti i revolucionit industrial kur pamë mekanizimin”. Ky transformim ngre pyetje të reja “të së drejtës dhe të së gabuarës me të cilat nuk po përballeshim më parë”. Ai mbështet vendosjen e “kornizave për të qeverisur përdorimin e inteligjencës artificiale në luftë” që duhet të zbatohen për ata njerëz që po punojnë në projektimin dhe përdorimin. Një nga çështjet që Singer e quan “lejueshmëria e makinës” është ajo që duhet të lejohet të bëjë makina përveç kontrollit njerëzor. Ai tërheq vëmendjen në një çështje të dytë me të cilën nuk jemi marrë kurrë më parë, që është “llogaria e makinës”. “Nëse ndodh diçka, kë e mbajmë përgjegjës nëse është makina që ndërmerr veprimin? Është shumë e lehtë të kuptohet se me një makinë të rregullt, është më e vështirë të kuptohet kjo me një të ashtuquajtur makinë pa shofer”. Në fushën e betejës, a do të mbahej përgjegjëse makina nëse objektivi do të gabohej ose nëse civilët do të vriteshin si rezultat i kësaj?

Planeti që po rindërtojmë: Si e ndryshon aktiviteti njerëzor rrotullimin e Tokës

Si po e nxjerr inxhinieria njerëzore planetin jashtë ekuilibrit

Për shekuj me radhë, rrotullimi dhe orientimi polar i Tokës mendohej se drejtoheshin vetëm nga forcat natyrore - lëvizjet akullnajore, zhvendosjet tektonike dhe rrymat oqeanike. Por hulumtimet e fundit kanë zbuluar një të vërtetë tronditëse: strukturat e ndërtuara nga njeriu, veçanërisht digat, po i zhvendosin në mënyrë të matshme polet e planetit dhe po ndryshojnë rrotullimin e tij.

Fuqia e Fshehur e Digave

Që nga viti 1835, njerëzit kanë ndërtuar gati 7,000 diga të mëdha në të gjithë botën, duke ruajtur ujë të mjaftueshëm për të mbushur Kanionin e Madh dy herë. Kjo rishpërndarje masive e ujit ka zhvendosur masën e Tokës në mënyra që ndikojnë në rrotullimin e saj. Fenomeni, i njohur si endje e vërtetë polare, ndodh kur masa lëviz nëpër sipërfaqen e planetit, duke bërë që korja të rregullojë pozicionin e saj në lidhje me boshtin e rrotullimit.

Mendoni për Tokën si një top basketbolli që rrotullohet - ngjisni një copë argjile në njërën anë dhe topi lëkundet për të kompensuar. Kjo është në thelb ajo që digat po i bëjnë planetit tonë.

Zhvendosja Polare në Dy Faza

Hulumtuesit nga Universiteti i “Harvardit” hartuan ndikimin e ndërtimit të digave duke përdorur të dhëna nga 6,862 rezervuarë. Ata zbuluan se:

- 1835–1954: Digat e ndërtuara në Amerikën e Veriut dhe Evropë e zhvendosën Polin e Veriut rreth 20 cm në lindje drejt Rusisë.
- 1954–2011: Digat në Afrikën Lindore dhe Azi e përmbysën trendin, duke e zhvendosur polin 57 cm në perëndim drejt Amerikës së Veriut.

Në total, polet e Tokës janë zhvendosur mbi një metër për shkak të rishpërndarjes masive të shkaktuar nga diga.

Implikimet në Nivelin e Detit

Përtej lëvizjes polare, ndërtimi i digave ka ulur gjithashtu nivelin global të detit me gati 23 mm. Duke bllokuar ujin në brendësi të tokës, digat e pengojnë atë të kontribuojë në vëllimin e oqeanit. Kjo rënie artificiale ndërlikon modelet e klimës dhe parashikimet e nivelit të detit, veçanërisht ndërsa shkrirja e akullnajave dhe ngrohja e oqeanëve përshpejtojnë rritjen natyrore.

Pse ka rëndësi

Ndërsa një zhvendosje prej një metri në pole nuk do të shkaktojë një epokë akulli, është një kujtesë e fuqishme se infrastruktura njerëzore mund të ndikojë në sistemet në shkallë planetare. Këto gjetje i nxisin shkencëtarët të marrin në konsideratë ndryshimet e shkaktuara nga digat kur modelojnë skenarët e ardhshëm të klimës dhe tendencat e nivelit të detit.

Ndërsa vazhdojmë të riformësojmë peizazhet për energjinë dhe bujqësinë, mund të na duhet të rimendojmë se si edhe strukturat më të zakonshme - si digat - mund të ndryshojnë ekuilibrin e botës sonë që rrotullohet.

Rishpërndarja e Masave: Forca e Padukshme

Pas Zhvendosjes Planetare

Sa herë që lëvizim sasi të mëdha mase - qoftë duke ndërtuar megastruktura, duke pompuar ujëra nëntokësore ose duke shkrirë



akullnajat - ne po ndryshojmë mënyrën se si shpërndahet pesha në të gjithë sipërfaqen e Tokës. Kjo ndikon në momentin e inercisë së planetit, i cili nga ana tjetër ndikon në rrotullimin e tij dhe pozicionin e poleve të tij gjeografike.

- Digat dhe Rezervuarët: Ndërtimi i gati 7,000 digave që nga shekulli i 19-të ka zhvendosur polet e Tokës me mbi një metër. Këto diga bllokojnë trilionë litra ujë në brendësi, duke tërhequr masën larg oqeanëve dhe duke shtyrë në mënyrë delikate boshtin e rrotullimit të planetit.

- Nxjerrja e Ujërave Nëntokësore: Midis viteve 1993 dhe 2010, njerëzit pompuan mbi 2,150 gigatonë ujëra nëntokësore, shumica e të cilave përfunduan në oqeanë. Kjo rishpërndarje zhvendosi boshtin e Tokës me gati 80 cm, sipas studimeve të fundit.

- Shkrirja e Shtresave të Akullit: Ndryshimi i klimës po përshpejton shkrirjen e akullit të Groenlandës dhe Antarktidës. Ndërsa masa e akullit lëviz nga polet në oqeanë, Toka bëhet pak më e rrafshët në ekuator, duke ngadalësuar rrotullimin e saj dhe duke ndryshuar zhvendosjen e polit.

Matja e Kohës dhe Sekondat e Brishta

Rrotullimi i Tokës nuk është vetëm një kuriozitet planetar - është themeli i sistemeve tona të matjes së kohës. Ndërsa rrotullimi ngadalësohet ose përshpejtohet, shkencëtarët duhet të rregullojnë Kohën Universale të Koordinuar (UTC) duke përdorur sekondat e brishta.

- Historikisht, sekondat e brishta janë shtuar për të llogaritur ngadalësimin gradual të Tokës për shkak të baticave hënore.

- Tani, për shkak të ndryshimeve të shkaktuara nga klima, shkencëtarët mund të kenë nevojë të zbresin një sekondë të brishta për herë të parë - ndoshta rreth vitit 2029.

Ndikimet në Navigim dhe Teknologji

Edhe ndryshimet e vogla në rrotullimin dhe boshtin e Tokës mund të ndikojnë në: Sistemet e pozicionimit satelitor si GPS, të cilat mbështeten në modele të sakta të Tokës; Modelet e klimës, të cilat duhet të marrin parasysh rishpërndarjen masive për të parashikuar me saktësi rritjen e nivelit të detit dhe Matjet gjeofizike, duke përfshirë gravitetin dhe deformimin e kores, të cilat janë të ndjeshme ndaj lëvizjes polare.

Një Thirrje Zgjimi për Qëndrueshmëri

Fakti që inxhinieria njerëzore mund të ndryshojë rrotullimin e Tokës është një kujtesë e fuqishme e gjurmës sonë planetare. Ndërsa këto ndryshime nuk do të shkaktojnë ndryshime katastrofike, ato nxjerrin në pah nevojën për:

- Vlerësime të integruara mjedisore që marrin në konsideratë efektet në shkallë planetare.

- Planifikim më të zgjuar të infrastrukturës, veçanërisht për megaprojektet e ardhshme.

- Bashkëpunim global për të monitoruar dhe zbutur pasojat e padëshiruara.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, Shqipëria e sapoçliruar u përball me sfida të mëdha për të ruajtur pavarësinë dhe stabilitetin e saj. Ndër këto sfida ishte lufta kundër grupeve diversante, të cilat u organizuan dhe mbështeteshin nga jashtë me synimin për të destabilizuar qeverinë komuniste të vendosur nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, por dhe lufta për t'u shëruar nga plagët e rënda të marra në luftimet e përgjakshme të luftëtarëve partizanë me nazistët gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Nga një studim i bërë për dëshmorët e rënë në vitin e parë të çlirimit më 1945, në bashkinë e Pogradecit, del se kanë dhënë jetën në luftime, por edhe kanë ndërruar jetë nga plagët e rënda të marra në luftë, tetë luftëtarë të cilët me vendime të organeve përkatëse janë shpallur dëshmorë të Atdheut.

Në këtë 80-vjetor të rënies së tyre, përveç një tufë me lule në varrezat e dëshmorëve të bashkisë Pogradec, ata kujtohen me nderim dhe respekt për sakrificat që kaluan nëpër betejat për çlirimin e Shqipërisë dhe gjakun e derdhur. Ishte viti i parë i lirisë, por përsëri shumë luftëtarë nga plagët e shkaktuara nga lufta, nuk mundën ta shijonin lirinë dhe të ndërtonin vendin...të tjerë ishin në ndjekje dhe roje të popullit. Ata, natë dhe ditë u ndeshën dhe ranë në përpjekje me bandat diversante që ishin të shumta për të përmbysur pushtetin e popullit, përsëri vijuan të binin dëshmorë të tjerë...

Nga Pogradeci ra në Kelmend kundër bandave

Ahmet Ajdin Gjona i lindur më 20 shtator 1912, në fshatin Laktesh të rrethit të Pogradecit në një familje me tradita atdhetare. Familjarisht kanë simpatizuar dhe ndihmuar lëvizjen. Ahmeti u bë një veprimtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare në dhjetor 1942. Ai bënte pjesë në njësitin e fshatit dhe u shqua për aktivitet në favor të lëvizjes. Në mars 1944 del partizan dhe bëhet efektiv i Brigadës I Sulmuese, ku dallohet në luftime, shfaq besnikëri dhe trimëri. Pas çlirimit vijonte lufta kundër bandave diversioniste që ishin grupe të armatosura dhe kundërshtonin pushtetin e popullit. Reparti ku bënte pjesë më 15 gusht 1945, ra në përpjekje me bandat diversante në Kelmend të Shkodrës. Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76, datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec.

Luftëtari punëtor që mbeti në Tropojë

Ali Bajram Mukollari ka lindur më 1 shtator 1912, në qytetin e Pogradecit në një familje punëtoare. Me vështirësi kryen disa vite shkollë dhe punoi punëtor krahu. Me nisjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare është aktivizuar duke kryer me përpikëri detyrat e ngarkuara. Doli partizan në verën e vitit 1943, duke u rreshtuar në çetën partizane të Mokrës dhe më pas në batalionin partizan të Mokrës. Në dhjetor 1943, u rreshtua partizan në Brigadën IV Sulmuese dhe mori pjesë në të gjitha luftime të zhvilluara. Në një nga luftime në veri të vendit u plagos rëndë. U shtrua në Spitalin Ushtarak të ngritur në Tropojë, por nga plaga e marrë ndërroi jetë në shkurt të vitit 1945. Është shpallur Dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76 datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec.

U plagos në luftën për Tiranën dhe ngeli aty

Bahri Beqir Belegu ka lindur më 30 prill 1900, në fshatin Laktesh të rrethit të Pogradecit në një familje të varfër, por atdhetare. Përkrahu Lëvizjen Nacionalçlirimtare me fillimin e vitit 1942, duke qenë anëtar i njësitit partizan të fshatit Laktesh. Në qershor të vitit 1944 doli partizan dhe u rreshtua në batalionin e Mokrës. U dallua në luftime kundër nazistëve gjermanë dhe xhandaro-ballistëve. Në luftime për çlirimin e Tiranës në përbërje të Brigadës IV Sulmuese plagoset rëndë dhe shtrohet në spital. Me gjithë përpjekjet e bëra nga mjekët dhe kuraja e Bahriut, ndërroi jetë në mars të vitit 1945, në Spitalin e Tiranës. Është shpallur Dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 118, datë 02.10.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Pogradecit dhe i është njohur statusi Dëshmor i Atdheut.

Guri i Kamjes, dëshmitari historik

Dilaver Muredin Kasmollari, ka lindur më 15 korrik 1920, në fshatin Omçan të Mokrës rrethi Pogradec, në një familje të varfër, por me ndjenja patriotike. Familjarisht të lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Veprimtar i lëvizjes nga muaji mars 1942, mori

Dëshmorë të rënë në vitin e parë të lirisë

DËSHMORË TË RËNË NË VITIN E PARË TË LIRISË 1945 - Bashkia Pogradec



Ali Bajram Mukollari



Bahri Beqir Belegu



Dilaver Muredin Kasmollari



Dhimitër Vasil Buzo



Ahmet Ajdin Gjona



Shaban Hysen Çela



Halit Beqir Palla



Tahir Hajdar Shuli



Sabri Ali Piperi

pjesë në rininë antifashiste dhe dallohej në zbatimin e detyrave. Në muajin mars 1944, doli partizan dhe u aktivizua me komandën e vendit në Velçan të Mokrës. Me çlirimin e vendit u aktivizua në repartet e ndjekjes popullore. Ra dëshmor më datën 5 korrik 1945, në Gurin e Kamjes, në përpjekje me kriminelë diversantë. Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76, datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec.

E ktheu shtëpinë në bazë të luftës

Dhimitër Vasil Buzo ka lindur më 4 shkurt 1914, në qytetin e Pogradecit, në një familje me tradita patriotike, me arsim fillor. Në prill 1942, u bë anëtar i grupit komunist të qytetit dhe një aktivist i dalluar. E ktheu shtëpinë e tij në bazë të rëndësishme të LANÇ-it, ku bëheshin mbledhje të celulës së PK për Pogradecin. Më 15 gusht 1943, del partizan në batalionin e Mokrës, duke u bërë intendent i batalionit. Gjatë operacionit të Dimrit 1944 mori një plevit, si dhe u plagos në një luftim. Çlirimi i vendit e gjeti me plagë në trup dhe më 15 dhjetor 1945, ndërroi jetë në spital si pasojë e sëmundjes së rëndë që kishte marrë gjatë luftës. Është shpallur Dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec, nr. 76, datë 02.12.1970 dhe i është njohur statusi "Dëshmor i Atdheut".

Korrieri partizan...

Halit Beqir Palla ka lindur më 1920, në fshatin Çezmë e Madhe të Mokrës, në një familje të varfër, por me ndjenja atdhetare. Shtëpia e familjes Palla u bë që në fillim të luftës bazë e rëndësishme. Halili u shqua si një veprimtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare nga fillimi i vitit 1942. U dallua si aktivist, anëtar i rinisë antifashiste dhe i njësitit partizan të fshatit. Ishte i shpejtë dhe kreu detyrën e korrierit partizan të ndërlidhjes në zonën e Mokrës midis forcave partizane dhe ilegale në qytetin e Pogradecit. Mori pjesë në luftime dhe në muajin mars 1944, në zonën e Mokrës, luftoi kundër forcave gjermano-balliste. Duke kryer detyrat si korrier ndërlidhës, plagoset dhe sëmuret rëndë. Ndërroi jetë me fillimin e vitit 1945. Komisioni Qendror i Statusit me vendim nr. 52 datë 17.05.2005 e ka shpallur Dëshmor të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i ka njohur statusin "Dëshmor i atdheut".

Edhe me plagë vijoi luftimet...

Sabri Ali Piperi ka lindur më 20 gusht 1922, në qytetin e Pogradecit në një familje të varfër punëtoare. U bë veprimtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe në muajin tetor 1943, u pranua në organizatën e rinisë komuniste. U tregua në luftime antifashist,

luftëtar i shkathët dhe i palodhur. Në muajin maj 1944 del partizan dhe rreshtohet Brigadën IV Sulmuese. Mori pjesë në disa luftime të zhvilluara nga brigada. Në një nga luftime kundër gjermano-ballistëve plagoset rëndë. Pasi mjekohet përsëri vijon luftime... Plaga e marrë në luftë u përkeqësua dhe më 5 korrik 1945 ndërron jetë në Spitalin e Shkodrës. Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76, datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec dhe i është njohur statusi "Dëshmor i Atdheut".

I riu që nuk u tërhoq kurrë nga luftime...

Shaban Hysen Çela u lind më 15 shkurt 1928 në fshatin Slabinjë të Mokrës së Poshtme në një familje të varfër, por me ndjenja patriotike. Në moshë të re mori pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, në vitin 1943, bëhet anëtar i rinisë antifashiste. Në muajin prill 1944 del partizan dhe rreshtohet në përbërjen e batalionit "Reshit Çollaku". Më vonë shkon partizan në Brigadën II Sulmuese. Gjatë luftimeve plagoset rëndë nga një predhë mortaje dhe shtrohet në spitalin partizan. Plaga ishte e rëndë dhe në janar 1945, ndërron jetë në Spitalin e Korçës. Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76, datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec dhe i është njohur statusi "Dëshmor i Atdheut".

Trim i që ra në Koplik

Tahir Hajdar Shuli ka lindur në vitin 1925 në fshatin Velçan të Pogradecit. Familja e tij u aktivizua me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Tahir Shuli u aktivizua që me fillimin e vitit 1943, me rininë antifashiste dhe ishte anëtar i njësitit luftarak të fshatit. Në mars 1944 del partizan dhe bëhet efektiv i Brigadës XV Sulmuese, ku dallohet në luftime, shfaq besnikëri dhe trimëri. Pas çlirimit vijonte lufta kundër bandave diversioniste që ishin grupe të armatosura dhe kundërshtonin pushtetin e popullit. Reparti ku bënte pjesë, më 15 gusht 1945, ra në përpjekje me bandat diversante në Koplik të Shkodrës. Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 76, datë 02.12.1970 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec.

Për dëshmorët sado që të bëhet gjithmonë është shumë pak, sepse gjaku i derdhur për Atdheun nuk ka çmim, nuk ka fjalë për të thënë, por ka vetëm pavdekësi të veprës së tyre. Pavdekësia e dëshmorëve është në memorien e përhershme të lirisë, të pavarësisë dhe të çlirimit të kombit shqiptar. Në shekuj kombi e ka larë vendin me gjakun e derdhur në rugën e zhvillimit dhe të përparimit, në rrugën e mbijetesës në saje të gjakut të derdhur në altarin e lirisë së kombit.



BËHU LIDERI I SË

NE SËRME



Forcat e Armatosura të Shqipërisë po ndërtojnë një të ardhme të fortë, duke investuar në ekspertizën, etikën dhe përkushtimin e brezit të ri. Politika e re e burimeve njerëzore vendos në qendër aftësitë luftarake, ekselencën akademike, disiplinën, kulturën, patriotizmin dhe vetëdijen historike. Rritja e aplikimeve vit pas viti dëshmon besimin në misionin tonë dhe në cilësinë e strukturës arsimore ushtarake.

Apliko tani dhe bëhu pjesë e Akademisë që formon liderët e së nesërme!
Shërbe me dinjitet, profesionalizëm dhe krenari në zemër të Shqipërisë!
Zgjidh të ardhmen! Zgjidh Akademinë Ushtarake!

APLIKO

NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA!

APLIKO NË:
<https://ualbania.al/>